



REPUBLIKA E SHqipëRIE
KRYEMINISTRIA

departamenti
dap
Administratës Publike



RAPORTI VJETOR I MONITORIMIT 2022

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE
E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE



Copyright © 2023, **Departamenti i Administratës Publike**
Të gjitha të drejtat e rezervuara

TABELA PËRMBELEDHËSE

01 LISTA E AKRONIMEVE	4
02 PREAMBULA	5
03 PROGRESI I STRATEGJISË	6
04 SHTYLLA I: POLITIKËBËRJA DHE CILËSIA E LEGJISLACIONIT	16
05 SHTYLLA II: ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE	22
06 SHTYLLA III: SHËRBIMI CIVIL: MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE	27
07 SHTYLLA IV: PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE MBIKËQYRJA	36
08 KOMUNIKIMI I AKTIVITETEVE	43
09 ANEKS: Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit të strategjisë	45

LISTA E AKRONIMEVE

AKSHI	AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT
ADISA	AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA
BE	BASHKIMI EVROPIAN
DAP	DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DZHM	DEPARTAMENTI I ZHVILLIMIT DHE MIRËQEVERISJES
EAMIS	SISTEMI I MENAXHIMIT TË ASISTENCËS SË HUAJ
HRMIS	SISTEMI INFORMATIK I MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE
IP SIS	SISTEMI I PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR TË MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT
IPS	SISTEMI I PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR
KMSHC	KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
KDIMDP	KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
KE	KOMISIONI EUROPIAN
KPI	INDIKATORËT KYÇ TË PERFORMANCËS
ML	MINISTRI LINJE
NC	NËPUNËS CIVIL
OECD	ORGANIZATA PËR BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM EKONOMIK
OJF	ORGANIZATË JOFITIMPRURËSE
OSS	ONE SINGLE SYSTEM (NJË SISTEM I VETËM)
OZHQ	OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM
PBA	PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM
PFM	MENAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE
PKIE	PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN
RENjK	REGJISTRI ELEKTRONIK PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK
ReSPA	SHKOLLA RAJONALE E ADMINISTRATËS PUBLIKE
RIA	VLERËSIMI I NDIKIMIT RREGULLATOR
SIGMA/OECD	SUPPORT FOR IMPROVEMENT IN GOVERNANCE AND MANAGEMENT
SKZHI	STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM
SNRAP	STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE
TIK	TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

PREAMBULA



I nderuar lexues,

Ju prezantojmë me raportin e monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës së Administratës Publike, për vitin 2022.

Viti 2022 shënon vitin përmbyllës të realizimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës së Administratës Publike SNRAP, 2015-2022, një dokument strategjik ambicioz që udhëhoqi përpjekjet e institucioneve të administratës publike drejt rrugës sfiduese të reformimit.

Ndjehemi vërtet krenarë për atë që është arritur gjatë kësaj periudhe, pavarësisht sfidave e vështirësive, një rrugë e re është nisur nëpërmjet procesit transformues të digjitalizimit të ofrimit të shërbimeve publike, një rrugë e re cila nuk ka kthim pas.

Çelja e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe zhvillimi i Konferencës së parë Ndërqeveritare Shqipëri-BE, në Korrik të vitit 2022, shënuan një hap tjetër të rëndësishëm në rrugëtimin tonë drejt familjes së madhe evropiane. Ky moment i rëndësishëm na tregon se përpjekjet tona të përbashkëta dhe angazhimi i vazhdueshëm në reforma po sjellin rezultate të vlefshme në drejtim të integritimit të plotë të vendit tonë në strukturat evropiane.

Administrata publike ka një rëndësi të veçantë në procesin e integritimit të Shqipërisë në BE. Përveç faktit që administrata publike është një element horizontal që kontribuon në të gjitha fushat dhe sektorët e qeverisjes, në rastin e Shqipërisë, Reforma e Administratës Publike është futur për herë të parë në procesin e negociimit për integrimin në BE dhe do të ketë një kapitull të veçantë negociues, nën Grup Kapitullin 1- Themeloret.

Jemi në përfundim të hartimit të strategjisë së re të reformës në administratën publike, duke e ndërtuar atë mbi eksperiencën e deritanishme dhe mësimet e nxjerra.

Vizioni ynë do të vazhdojë të orientohet drejt krijimit të një administrate publike profesionale, transparente, me integritet që ofron shërbime publike cilësore, të shpejta dhe me kosto sa më ulët për të gjithë, e aftë të përballojë të gjitha sfidat e procesit të integritimit në BE.

Në mbyllje, një falenderim nga zemra për të gjithë nëpunësit që u angazhuan në jetësimin e aktiviteteve që realizuam gjatë kësaj periudhe si dhe partnerët ndërkombëtarë e aktorët e shoqërisë civile që na mbështetën e shoqëruan në çdo hap të këtyre proceseve transformuese- Në këtë rrugëtim sfidues ne jemi bashkë, prandaj mirëpresim çdo sugjerim e çdo këshillë tuajën për të përmirësuar më tej përpjekjet tona për zhvillim!

Faleminderit

Departamenti i Administratës Publike



PROGRESI I STRATEGJISË

Reformat e zbatuara me sukses për periudhën e raportimit

Reforma në Administratën Publike është një ndër elementët nën shtyllën “Themelet: Qeverisja e mirë, demokracia dhe shteti i së drejtës” të SKZHI 2015-2020, me vizionin e zhvillimit të një administrate publike në përputhje me standartet e Administratës Evropiane me qëllimin për të ofruar shërbime me cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset, në mënyrë transparente dhe efikase përmes përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve novatore, në përputhje me Integrimin Evropian, me anë të punonjësve civilë të paanshëm dhe profesionistë si pjesë e strukturave efikase, vizion ky dhe i Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike (SNRAP).

Që në fazat e para të hartimit të SNRAP, është synuar ndërlidhja midis politikave të përcaktuara në SKZHI dhe objektivave afatgjata të cilat kanë për qëllim kryesisht përmirësimin e efektivitetit të administratës publike dhe uljen e korrupsionit; krijimin e një sistemi profesional, të paanshëm dhe të bazuar në merita si dhe përmirësimin e shërbimeve publike dhe të procedurave administrative dhe mbikëqyrëse.

Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike, e miratuar në 15 Prill 2015 nga Qeveria Shqiptare, shërben si një dokument strategjik që orienton reformimin e administratës bazuar në katër shtylla kryesore, **11 objektiva të qarta** strategjike, planin e veprimit 2018-2022 i cili parashikon zbatimin e **130 nën-aktiviteteve** konkrete dhe pasaportës së indikatorëve:

Shtylla I: Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit (46 nën-aktivitete);

Shtylla II: Organizimi dhe Funkionimi i Administratës Publike (18 nën-aktivitete);

Shtylla III: Shërbimi Civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore (36 nën-aktivitete);

Shtylla IV: Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja (30 nën-aktivitete).

Gjatë këtyre **8 viteve**, SNRAP 2015-2022 ka kaluar në disa faza të rëndësishme si:

- Miratimi i Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën e Administratës Publike (2015);
- Rishikimi afatmesëm që konfirmoi rëndësinë e shtyllave dhe objektivave strategjike (2017);
- Miratimi i planit të veprimit SNRAP 2018-2020 ku janë marrë në konsideratë arritjet, sfidat dhe rekomandimet e strukturave ndërkombëtare (2018);
- Hartimi dhe miratimi i planit të ri 2018-2022, afati i të cilit u zgjat dhe u shtuan aktivite për të ofruar mbështetje strategjike për programimin e fondeve IPA (2019);
- Përcaktimi i vlerave të synuara mbi treguesit në nivel rezultati për 2021-2022, pjesë e pasaportës së indikatorëve (gjatë 2021).

Raporti vjetor i monitorimit të SNRAP 2021 është miratuar në takimin e Grupit Tematik "Reforma në Shërbimin Civil dhe SNRAP", të datës 26 Prill 2022 dhe më pas është bërë publik.

Gjithashtu është përgatitur edhe raporti i monitorimit të gjashtë-mujorit të parë të vitit 2022 i cili është konsultuar me institucionet respektive, gjatë muajit shtator-tetor 2022.

Viti 2022 përkoi me mbarimin e afatit të kohëzgjatjes së Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike.


Departamenti i Administratës Publike në cilësinë e institucionit përgjegjës për monitorimin e zbatimit të SNRAP vlerëson si prioritar dhe tejet të rëndësishëm procesin e shkrimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike për vitin 2023 e në vijim.

Raporti i aktiviteteve të cilat janë realizuar për periudhën 2018-2022 është 82% e totalit të aktiviteteve të Planit të Veprimit.

Numri i nën-aktiviteteve të cilat janë realizuar është si vijon:

- Në Fushën I "*Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit*": **36 nën-aktivitete nga 46 në total**;
- në Fushën II "*Organizimi dhe funksionimi i administratës publike*": **14 nën-aktivitete nga 18 në total**;
- në Fushën III "*Shërbimi Civil: Menaxhimi i burimeve njerëzore*": **28 nën-aktivitete nga 36 në total** si dhe në Fushën IV "*Procedurat administrative dhe mbikëqyrja*": **25 nën-aktivitete nga 30 në total**.


Numri i nën-aktiviteteve të realizuara plotësisht sipas shtyllave



Informacion i përmbledhur:


Plani i Veprimit 2018-2022 parashikon zbatimin e 35 aktiviteteve bazë dhe 130 nën-aktiviteteve në total. Deri në fund të vitit 2022, nga 130 nën-aktivitete në total, 126 prej tyre janë zbatuar (103 prej tyre ose 82% vlerësohen si të realizuara plotësisht dhe 23 prej tyre ose 18% janë realizuar pjesërisht).

Statusi i përgjithshëm i realizimit të nënaktiviteteve (që kanë filluar zbatimin) gjatë vitit 2022



■ Realizuar plotësisht ■ Realizuar pjesërisht

Numri i nën-aktiviteteve të realizuara plotësisht gjatë vitit 2021



■ Realizuar plotësisht ■ Realizuar pjesërisht

Sa i takon numrit të nën-aktiviteteve të porealizuara dhe afateve të tyre për t'u finalizuar, 4 nënaktivitete janë jashtë afateve të parashikuara për të filluar zbatimin. Vlen të theksohet që këto nën-aktivitete do të vijojnë të jenë relevante dhe në strategjinë e re për shkak të prioriteteve të identifikuara për periudhën në vijim.

Këto nën-aktivitete janë:

- dizenjimi dhe përshtatja e platformës IPSIS për përdorim nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, pilotimi i implementimit të sistemit në 5 bashki;
- hartimi i strategjisë për kuadrin mirërrregullator/better regulation multi-action annual plan dhe planit të veprimit;
- miratimi i vendimeve të reja për pagat dhe zbatimin e strukturës së re;
- zbatimi i programit "Young Civil Servant Scholarship Scheme" dhe qëndrueshmëria e kësaj praktike; Departamenti i Administratës Publike ka përgatitur Guideline për programin "Ngritja e kapaciteteve për nëpunësit civilë të Administratës Publike, përfshirë trajnimet / praktikat në administratat e Shteteve Anëtare të BE-së dhe skemën e bursave ("qelizat e reja")" financuar nga programi kombëtar IPA 2020. Zbatimi ka nisur në Shkurt të vitit 2023.

Shtylla I: Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit

Kuadri strategjik për reformën në administratën publike

Në këtë kuadër:

- qeveria shqiptare është angazhuar të ndërmarrë vendimet e duhura strategjike dhe për këtë arsye janë ngritur strukturat që harmonizojnë proceset administrative dhe shërbejnë si urë lidhëse ndërmjet nivelit politik dhe teknik. Duke filluar nga Qershori 2022, Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve i është ngarkuar përgjegjësia për përmbushjen e parimeve të mirëqeverisjes;

- për të siguruar efikasitet të procesit është mbajtur rregullisht Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS), si niveli më i lartë i vendimmarrjes i drejtuar nga Kryeministri, që mbështetet në nivel teknik nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC). Ndër të tjera në këtë komitet është diskutuar dhe vizioni i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 (SKZHIE III), dokumenti final i të cilit është publikuar në faqen e konsultimit publik dhe është miratuar tashmë në datë 22.02.2023 pas një procesi konsultimi të gjerë;

-progresi në fushën e RAP dhe çështjet të tjera kryesore mbi zbatimin e 5 strategjive nën RAP diskutohen në grupin e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) për Mirëqeverisjen i cili drejtohet nga Ministri i Shtetit për Shërbimet dhe Standardet, si anëtar i përhershëm i KPS-së.

Gjatë kësaj periudhe ka nisur dhe procesi i përgatitjeve për shkrimin e strategjive të reja nën RAP dhe konsultimin e tyre, konkretisht për:

- Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike;
- Strategjinë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore;
- Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit.

Konsultimi publik – si një komponent i rëndësishëm i mirëqeverisjes me ndikim në rritjen e cilësisë së llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve publike si dhe forcimin e demokracisë. Për të forcuar këtë proces ndër vite janë marrë masa për të plotësuar mekanizmat ligjorë dhe institucionalë që sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në konsultimin e politikave publike duke hartuar paketën metodologjike dhe udhëzimet për unifikim të procesit.

Tashmë konsultimi publik ndiqet nga Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë, një hap ky që ka mundësuar lidhjen e konsultimit publik dhe vlerësimin e ndikimit të akteve për të patur një ndërlidhje të dy komponentëve me ndikim të ndërsjelltë në rritjen e cilësisë së procesit të hartimit e më pas të konsultimit të akteve ligjore.

Treguesit për **këtë periudhë** janë inkurajues:

- në nivelin 81.63% vlerësohet indeksi i frekuencës së konsultimeve publike ndërsa indeksi për cilësinë është 6.34 nga 7;
- rritur numri i grupeve të interesit të përfshirë në takimet konsultative - rreth 2313 pjesëmarrës, nga të cilët 477 kanë kontribuar me komente;
- procesi është shtrirë dhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ku janë marrë masa për (i) krijimin e infrastrukturës të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) për publikimet dhe konsultimin edhe nga bashkitë për dokumenta me interes të lartë vendor dhe (ii) caktimin e një koordinatori zyrtar që do të koordinojë teknikisht procesin me 61 bashkitë.

Vlerësimi i Ndikimit Rregullator (RIA).

Tashmë aktet ligjore shoqërohen me raportin RIA përkatës përpara miratimit të tyre dhe sipas një vlerësimi pikët mesatare të raporteve RIA të konfirmuara janë 80 nga 100₂. Për të përmirësuar akoma më tej këtë proces, vëmendje i është kushtuar ngritjes së kapaciteteve të stafeve për të kryer procesin sipas standardeve. Që nga prezantimi i këtij procesi (nga 2019) janë zhvilluar: 25 sesione trajnimi për rrjetin RIA, 10 sesione trajnimi për Njësinë RIA, si dhe janë trajnuar më shumë se 100 nëpunës civilë.

1 <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/02/22/88/59519cb2-2180-4e7e-9d91-68545a68e008;q=zhvillim%20dhe%20integrim%20evropian>

Shtylla II: Organizimi dhe Funksonimi i Administratës Publike

Me qëllim krijimin e strukturave efçente për të përmirësuar organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës publike, ka përfunduar tashmë procesi i ristrukturimit të institucioneve të varësisë në 4 sisteme ministrore (sistemet e shëndetësisë, arsimit, turizmit dhe bujqësisë). I gjithë procesi ka ecur paralelisht me rishikimin dhe standardizimin e përgjithshëm të përshkrimeve të punës për ministritë e linjës dhe përcaktimin e 20 proceseve horizontale dhe 40 proceseve vertikale të përshtatura në përputhje me fushën e përgjegjësisë për ministritë e linjës. Kjo u ka ofruar institucioneve mjetet e nevojshme për të siguruar që të ketë një kuptueshmëri standarde dhe të unifikuar të proceseve të punës.

Për të monitoruar këtë proces është i nevojshëm hartimi i projektligjit për ndryshimin e ligjit nr 90/2012 mbi kryerjen e disa rregullimeve përsa i përket tipologjisë së institucioneve, mekanizmit të mbikëqyrjes së performancës së institucioneve si dhe mënyrës së raportimit.

Vlen të theksohet se ky projektligj së bashku me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, janë akte të rëndësishme që mbulojnë fusha që lidhen me dy parimet kryesore të administratës publike, atë të shërbimit civil dhe menaxhimit të burimeve njerëzore dhe llogaridhënies. Këto dy ligje kanë qenë të përfshira edhe në rekomandimet e Grupit të Posaçëm për Reformën e Administratës Publike BE- Shqipëri (PAR SG).

Shtylla III: Shërbimi Civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore momentet kryesore ku është fokusuar puna ndërlidhen kryesisht me rekomandimet e lëna në raportin e fundit të Bashkimit Evropian në drejtim të:

- zhvillimit të diskutimeve mbi hartimin e projektligjit për ndryshimet e ligjit nr 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, nëpërmjet të cilit synohet të bëhen rregullime në lidhje me kriteret e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, kriteret për përparimin në hapat e pagës, organizimin dhe funksionimin e ASPA, lirimit, pezullimit, ecurisë disiplinore dhe çështje të tjera të evidentuara gjatë zbatimit të ligjit ndër vite;

- zhvillimit të **tetë takimeve konsultative** me partnerët SIGMA, përfaqësues të nivelit të lartë drejtues dhe ekspertë të fushës mbi skemën e pagave dhe reformën në këtë drejtim për të konkluduar në një propozim të përbashkët;

- aplikimit të metodave të reja për rritjen e efçencës, përgjegjshmërisë, angazhimit dhe motivimit të punonjësve publikë

- vijimit të bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë për të informuar studentët për vendet vakante, mënyrën e aplikimit, procedurat e rekrutimit dhe mundësitë e punësimit që ofron administrata publike;

- mbikëqyrjes së procesit të raportimit periodik lidhur me indikatorët bazë/treguesit e performancës së menaxhimit të burimeve njerëzore nga ana e institucioneve përfshirë dhe nivelin vendor përmes përdorimit të platformës “administrata al”;

- mbikëqyrjes së përgjithshme mbi zbatimin e ligjit “Për nëpunësin civil”, trajtimit të ankesave nga ana e KMSHC-së;

- monitorimit të zbatimit të vendimeve gjyqësore.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vijuar me nxjerrjen e udhëzimeve dhe rekomandimeve bazuar në problematikat e evidentuara. Kështu janë hartuar udhëzimet në drejtim të (i) respektimit të të drejtave politike të nëpunësve civilë, në kushtet e zgjedhjeve të pjesshme vendore; (ii) vlerësimit të veprimtarisë së nëpunësit civil në rrjetet sociale, në kushtet e zgjedhjeve të pjesshme vendore dhe (iv) riklasifikimin e pozicioneve të punës, për të gjithë sistemin e shërbimit civil në njësitë e qeverisjes vendore (bashki).

Ngritjes së e kapaciteteve - në lidhje me trajnimet e ofruara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, gjatë vitit 2022 janë trajnuar 5397 individë dhe ka patur ndjekje te trajnimeve për 20780 pjesëmarrës. Në total janë zhvilluar 665 ditë trajnimi nga të cilat 139 në bashkëpunim me projektet. Rëndësi gjatë kësaj periudhe i është dhënë ofrimit të trajnimeve për Bashkimin Evropian (3755 të trajnuar) duke qenë se roli i administratës publike është kyç në përgatitjen drejt rrugëtimit të Shqipërisë në BE. Gjithashtu trajnimet janë shtrirë dhe në fusha të tjera duke ofruar një gamë prej 108 tematikash të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve civilë sipas nevojave për trajnim të identifikuar gjatë vitit.

Shtylla IV: Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja

Shërbimet publike kanë shënuar një progres të rëndësishëm gjatë këtij viti me kalimin e të gjitha shërbimeve online duke bërë që sot të ofrohen 1,227 shërbime online ose rreth 95% e të gjitha shërbimeve publike krahasimisht me vitin 2013 kur ofroheshin vetëm 14 shërbime elektronike. Në portalin e-albania ofrohen 55 dokumente me vulë elektronike duke eliminuar tërësisht printimin e tyre në letër duke shënuar kështu një ndryshim radikal ku në 5 vite (shtator 2017 – dhjetor 2022) janë gjeneruar 23 milionë dokumente me vulë elektronike.

Marrja e shërbimeve përmes portalit e-Albania u ka kursyer qytetarëve dhe bizneseve 990 vite pritje nëpër radhë për marrjen e dokumentave shtetërore me vulë elektronike dhe rreth **9 milionë euro** në xhepat e tyre, nga heqja e tarifave të këtyre dokumentave që ofrohen tashmë pa pagesë në platformë në versionin e tyre elektronik. Për të mbështetur aktivitetet e përditshme të administratës publike dhe rritur efikasitetin duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuar dhe transmetuar informacione, tashmë janë të ndërlidhura 10 sisteme që kanë mundësuar përmirësimin e qarkullimit të informacionit në ofrimin e shërbimeve.

Muaji Maj (2022) shënoi një ndryshim tërësor të mënyrës së marrjes së shërbimeve, konsideruar faktin që të gjitha sportelet e shërbimeve u mbyllën dhe shërbimet publike ofrohen online. Kështu, për të mundësuar këtë nismë u realizuan ndryshimet e nevojshme në strukturat e institucioneve. Bazuar në këto ndryshime, stafi i Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara bashkëpunon me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje për monitorimin e zbatimit të afateve të përdorimit të Sistemit të Qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik si dhe ndjekjen e ecurisë së ankesave të administruara nga ADB. Kjo ka mundësuar një monitorim të procesit nga faza e shkëmbimit të dokumentacionit shoqëruës deri tek marrja e shërbimit me vulë elektronike si dhe ndjekjen e ankesave për marrjen e shërbimit.

Garantimi i të drejtës për informimin e qytetarëve si komponent i rëndësishëm i transparencës dhe llogaridhënies është përmirësuar dukshëm, duke ndikuar në rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Për të adresuar problematikat e ndryshme të hasura gjatë zbatimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, por edhe sugjerimet/propozimet e vazhdueshme të grupeve të interesit, doli si domosdoshmëri nevoja e përmirësimit të rregullave në këtë fushë. Për këtë qëllim, Zyra e Komisionerit hartoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119, datë 14.09.2014 “Për të drejtën e informimit” me qëllim përmirësimin dhe forcimin e rregullave dhe procedurave të legjislacionit aktual për (i) parashikimin e kompetencave të Komisionerit; (ii) rishikimin e kufijve minimalë të gjobës; (ii) bashkëpunimin e autoriteteve publike; (iii) mundësinë e sanksionimit të personit përgjegjës për refuzimin e dhënies së informacionit, përveç rasteve kur përgjegjës është koordinatori për të drejtën e informimit si dhe rastet për të cilat mban përgjegjësi titullari i autoritetit publik. Pritet që ndryshimet në ligjin nr. 119/2014 të miratohen gjatë vitit 2023.

Në lidhje me vënien në funksion të regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve deri në muajin dhjetor 2022, 195 autoritete publike kanë të instaluar REKPD.

Gjithashtu është ndjekur procesi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga institucioni i Avokatit të Popullit. Gjatë vitit 2022, janë adresuar 249 rekomandime drejtuar organeve të administratës publike. Nga 249 rekomandime të adresuara në total, numri i rekomandimeve të pranuar është 159 ndërsa numri i rekomandimeve të zbatuara plotësisht është 42 ose 26 % e rekomandimeve janë zbatuar plotësisht nga totali i rekomandimeve të pranuar.

Ndikimi i zhvillimeve të sektorit në rajon

Praktikat pozitive të Shqipërisë në fushat kryesore të Reformës në Administratën Publike janë referuar në raporte ndërkombëtare dhe studime krahasuese për vendet e rajonit. Në shkurt të vitit 2022 është publikuar një përmbledhje rajonale mbi raportet e monitorimit të SIGMA₃ ku Shqipëria shënon progres krahasimisht me vlerësimin e kryer në vitin 2017 në fushat e (i) koordinimit dhe zhvillimit të politikave; (ii) shërbime publike dhe menaxhimi i burimeve njerëzore; (iii) llogaridhënies; (iv) dhënia e shërbimeve dhe menaxhimi i financave publike.

Në fushën e burimeve njerëzore Shqipëria është vlerësuar me pikët më të larta në rajonin e Ballkanit Perëndimor duke tejkaluar mesataren rajonale bazuar në Raportin e Monitorimit të SIGMA (2021). Raporti e vlerësoi Shqipërinë përsa i takon stabilitetit dhe forcimit të sistemit të shërbimit civil, ngritjes së kapaciteteve dhe rritjes profesionale të nëpunësve civilë në përballimin me sukses të sfidave të integritetit drejt Bashkimit Evropian⁴. Për më tepër në vlerësimin e bërë nga SIGMA të publikuar në nëntor të vitit 2021, treguesi “Meritokracia dhe efektiviteti i rekrutimit të nëpunësve civilë” është vlerësuar me pikë maksimale (5 nga 5), krahasuar me 4 në vitin 2017.

Në lidhje me mënyrën se si ka avancuar procesi i koordinimit të politikave, Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA) ka [publikuar studimin kombëtar për proceset e koordinimit të politikave në Shqipëri](#). Studimi ofron një analizë të proceseve dhe strukturave të zhvillimit dhe koordinimit të politikave në Shqipëri, duke identifikuar mënyrat kryesore për të forcuar koordinimin e politikave si një mjet për zbatimin më efikas të Reformës së Administratës Publike. Referuar raportit, politikëbërja dhe koordinimi i politikave në vend ka treguar përmirësim. “Qasja e qeverisë për të përmirësuar politikëbërjen dhe koordinimin është vlerësuar si koherente, sistematike dhe e përshtatshme me anë të ngritjes dhe funksionimit të Grupeve të Integruara të Menaxhimit të Politikave dhe Komiteteve Drejtuese Sektoriale (KDS) brenda fushave dhe sektorëve prioritarë të politikëbërjes” (faqe 43).

Gjithashtu, ReSPA ka publikuar **dy raporte vetë-vlerësimi mbi rekrutimin e bazuar në meritë dhe vlerësimin e performancës** në vendet e Ballkanit Perëndimor. Përsa i përket raportit mbi [rekrutimin e bazuar në meritë](#), Shqipëria është tashmë një rast suksesi për digjitalizimin plotësisht të procedurave të rekrutimit, me fokus forcimin e infrastrukturës teknologjike për zhvillimin e këtyre procedurave. Sipas vlerësimit të bërë për rekrutimin e nëpunësve të administratës publike, procedurat e rekrutimit zhvillohen në bazë të legjislacionit të shërbimit civil të bazuara në meritokraci, transparencë dhe profesionalizëm. Evidentohet gjithashtu se aplikimi për pozicione vakante në administratën publike ka një qasje *user-friendly* dhe të thjeshtëzuar përmes të cilit aplikantët krijojnë dosjen e tyre personale. Raporti nënvizon gjithashtu se Departamenti i Administratës Publike i kushton një rëndësi të veçantë publikimit dhe vizibilitetit të shpalljeve për vendet e punës nëpërmjet informimit në rrjetet sociale, si dhe përmes zhvillimit të aktiviteteve promovuese apo workshop-eve të ndryshme me universitetet. Trajnimet e zhvilluara për njësitë e burimeve njerëzore në mënyrë që të rrisin cilësinë e planifikimit të stafit janë një tjetër element që vlerëson ky raport.

[ReSPA ka publikuar studimin mbi sistemet e informacionit të menaxhimit të burimeve njerëzore \(SIMBNJ\)](#) në shërbimin civil në Ballkanin Perëndimor. Studimi mbulon çështje të funksionaliteteve teknike dhe pespektivës së të dhënave në fushën e BNJ përfshirë dhe një analizë të përdorimit të SIMBNJ në Shqipëri. Studimi nënvizon se SIMBNJ ndërvepron me sisteme të tjera ndërqeveritare duke nxjerrë në pah një interoperabilitet të plotë në shkëmbimin e të dhënave. Funksionet e rekrutimit dhe seleksionimit janë të përfshira në sistemin e Shqipërisë duke nënvizuar se aplikimet e rekrutimit të përdorura janë në nivel të lartë të maturitetit digjital duke referuar testimin elektronik si një praktikë pozitive. Një aspekt tjetër i studiuar është dhe përfshirja e funksionaliteteve të trajnimeve dhe ngritjes profesionale të cilat tashmë janë pjesë e SIMBNJ. Rasti i Shqipërisë është dalluar ndër sistemet e tjera të studiuara në rajon për

ndërlidhjen e SIMBNJ me sistemet e-learning duke cituar se “Integrimi me regjistrat e tjerë qeveritarë është më i zhvilluar në Shqipëri ku disa module të SIMBNJ (menaxhimi i të dhënave personale, koha e punës, tranimet, rekrutimi elektronik dhe testimi elektronik) ndërveprojnë me MS dhe për këtë arsye shumë elementë të të dhënave mund të merren automatikisht në kohë reale nga bazat e tjera të të dhënave publike⁵.

Në lidhje me [raportin e vlerësimit të performancës së nëpunësve në administratën publike](#), si një proces tejet i rëndësishëm që duhet zhvilluar objektivisht dhe në mënyrë të drejtë, nënvizohet se Shqipëria ka investuar shumë në mbështetjen e procesit të vlerësimit të performancës me anë të aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve dhe kalimin e procesit në platformën “administrata.al”. Gjithashtu, argumentohet se procesi i vlerësimit për nëpunësit civilë është në linjë me praktikën e mira të vendeve të tjera si dhe rekomandon zhvillimin e mëtejshëm të kuadrit të kompetencave për pozicionet e punës (duke përjashtuar pozicionet e nivelit të lartë drejtues) në mënyrë që ato të përfshihen në procesin e vlerësimit të performancës.

[Kërkesat profesionale dhe kuadri i kompetencave në administratat e shërbimit civil në Ballkanin Perëndimor](#) janë përfshirë në studimin rajonal i cili shtrihet përtej kornizave të kompetencave të sjelljes për të analizuar kërkesat profesionale të shërbimit civil në përputhje me modelin e njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe attributeve të tjera për krijuar një kuptim më të gjerë dhe më të thellë të asaj që pritet nga nëpunësit civilë në kushtet e kërkesave dhe kompetencave profesionale. Në rastin e Shqipërisë është referuar rëndësia për të vlerësuar kompetencat gjatë intervistës së punës dhe rëndësia e zhvillimit të trajnimeve të vazhdueshme të komisioneve të vlerësimit për të përgatitur pyetjet bazuar në një kuadër të përcaktuar të kompetencave.

Në ceremoninë e ndarjes së çmimeve të Administratës Publike të organizuar nga ReSPA në 15 shtator 2022, Shqipëria është vlerësuar me çmimin “Për ndërtimin e besimit në administratën publike”. Komisioni i Prokurimit Publik u vlerësua për iniciativën “ankesa elektronike” (e-ankesa). Vlen të përmendet se roli i ReSPA në mbështetjen e anëtarëve të saj në drejtim të koordinimit të politikave të RAP-it, si dhe mbështetja në organizimin, zbatimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të kësaj reforme ka sjellë një kontribut të rëndësishëm, si në shkëmbimin produktiv të ideve në nivel politik por edhe në mbështetjen në ngritjen e kapaciteteve në nivel teknik.

Bordi drejtues i ReSPA është kryesuar nga Shqipëria gjatë vitit 2022. Qeveria Shqiptare ka qenë tërësisht e angazhuar për të rritur dialogun, bashkëpunimin rajonal dhe vëmendjen politike drejt fushave kryesore të administratës publike dhe integritetit evropian.

Ndikimi i zbatimit të strategjisë në agjendën e integritit evropian

Prioritetet në fushën e RAP janë përcaktuar në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, e miratuar me ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare", përkatësisht në nenin 111, "Administrata Publike" në nenin 6 të MSA-së "për mbledhjen e Këshillit të Stabilizim Asociimit" i cili shqyrton rregullisht zbatimin e marrëveshjes dhe realizimin e reformave përfshirë dhe reformën në administratën publike.

Në kontekstin e vendit tonë, parimet e administratës publike në të gjashtë fushat kryesore mbulohen nga një kornizë strategjike e konsoliduar e RAP, e cila përfshin Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës së Administratës Publike, Strategjinë Kundër Korrupsionit, Strategjinë e Agjendës Digjitale, Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike.



Gjithashtu progresi monitorohet bazuar në ecurinë e kryer për gjashtë parimet kryesore të Administratës Publike:

Duke konsideruar rëndësinë e kësaj reforme dhe prioritetin e saj në kuadër të integritit evropian, me qëllim sigurimin e një kornize afatmesme për një dialog më të strukturuar mbi administratën publike duke përfshirë qeverisjen lokale, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), është krijuar Grupi i Posaçëm për Reformën e Administratës Publike BE - Shqipëri (PAR SG).

Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2021 (në vijim të takimit të 9-të të grupit të posaçëm) është raportuar në takimin e 10-të të PARSG të zhvilluar në datë 28.01.2022. Diskutimet në këtë platformë kryesore shërbyen për të çuar përpara punën në kuadër të Reformës në Administratën Publike.

Zhvillimet në fushën e shërbimit civil dhe burimeve njerëzore në nivel qendror dhe vendor janë diskutuar dhe në takimin e 12-të të Komitetit të Stabilizim Asociimit të mbajtur në datë 15 shkurt 2022.

Zyrtarisht negociatat për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian janë çelur në [19 Korrik të 2022](#).

Si pjesë thelbësore e kriterit politik, Reforma në Administratën Publike, është përcaktuar të jetë ndër çështjet e para që do të vlerësohet. Departamenti i Administratës Publike ndjek këtë proces mbështetur në VKM-në nr. 422, datë 6.5.2020, të ndryshuar, në të cilën është përcaktuar se negociatori përgjegjës për reformën në administratën publike është drejtori i Departamentit të Administratës Publike.

Pas këtij momenti të rëndësishëm për vendin, është zhvilluar në datë 19 Shtator 2022 takimi shpjegues mbi procesin dhe përgatitjet për takimin bilateral për RAP.

Deri në takimin bilateral është koordinuar puna me institucionet kontribuese sipas 6 parimeve të RAP dhe është përgatitur kontributi narrativ mbi zhvillimet kryesore sipas pikave të agjendës së takimit bilateral. Në datë 21 Nëntor DAP organizoi takimin përgatitor për procesin dhe diskutimet bilaterale mbi RAP.

Takimi bilateral u zhvillua në Bruksel në datë 12 Dhjetor 2022 ku u prezantuan për çdo parim arritjet kryesore, planet e ardhshme dhe sfidat kryesore të cilat priten të adresohen gjatë procesit.

Me fillimin e një procesi kaq të rëndësishëm do të kërkohet gjithashtu një angazhim i përbashkët institucional në përmbushjen me sukses të detyrimeve për aderim sa më të shpejtë në Bashkimin Evropian.

[Raporti i fundit i Komisionit Evropian](#) për vitin 2022 citon se “Shqipëria mbetet në mënyrë të moderuar e përgatitur në fushën e reformës në administratën publike. Kapacitetet për konsultimin publik dhe vlerësimin e ndikimit të impaktit rregullator janë forcuar, përgatitjet për reformën e pagave kanë filluar dhe sistemi i automatizimit të listëpagesave është zgjeruar.

Zbatimi i strategjisë së Reformës në Administratën Publike dhe Menaxhimit të Financave Publike ka vijuar. Dispozitat e parashikuara për rekrutimin bazuar në meritë në ligjin e shërbimit civil mbeten për tu implementuar plotësisht, veçanërisht për pozicionet e larta drejtuese.

Shqipëria ka vënë në zbatim një platformë gjithëpërfshirëse për shërbimet digjitale – kalimi i shpejtë drejt 100% të shërbimeve online u iniciua në 1 Maj 2022. Megjithatë, nevojitet të sigurohet akses i barabartë për qytetarët me aftësi digjitale të limituara”.

Rekomandime kryesore do të vijojnë të mbeten:


- rritja e kapaciteteve për monitorimin dhe planifikimin e politikave dhe të sigurohet që institucionet e varësisë dhe organet mbikëqyrëse të administratës qendrore të jenë të mirëstrukturuara dhe të kenë të përcaktuara role të qarta;
- përgatitja e strategjisë për reformën e administratës publike dhe menaxhimit të financave publike në linjë me strategjitë sektoriale relevante ndërsa në të njëjtën kohë duhet të rishikohet efektiviteti i strukturave aktuale të monitorimit;
- zbatimi në mënyrë efektive i përcaktimeve në ligjin e nëpunësit civil mbi rekrutimin e bazuar në meritë në të gjitha nivelet, veçanërisht për nivelin e lartë drejtues, reformimi i sistemit të pagave dhe zgjerimi i mëtejshëm i automatizimit të sistemit të listëpagesave.

POLITIKËBËRJA DHE CILËSIA E LEGJISLACIONIT


Politikat nën këtë shtyllë synojnë forcimin e sistemit të planifikimit strategjik, monitorimit të politikave dhe legjislacionit, raportimit dhe vlerësimit që i shndërron prioritetet e qeverisë në veprime konkrete. Përmes ngritjes së sistemeve të informacionit për planifikimin e politikave dhe financave publike synohet përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit midis ministrive, rritja e transparencës për dokumentet strategjike të qeverisë dhe monitorimit në kohë reale.

Shtylla 1 "Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit" parashikon realizimin e 46 nën-aktiviteteve. Nga totali i 44 nën-aktiviteteve të cilat kanë qënë në zbatim, 36 nën-aktivitete janë realizuar plotësisht, 8 janë realizuar pjesërisht.

Statusi i realizimit të qëllimit politik:
Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit



Statusi i realizimit të produkteve sipas Objektivave



Lista e indikatorëve me vlerën bazë, vlerën e matur dhe vlerën e synuar në 2022

Indikatorët	Vlera Bazë	Vlera e matur në 2022	Vlera e synuar për 2022	Trendi (tendencë në ulje/tendencë në rritje/ arritur)	
2a. Cilësia e analizës së vlerësimit të ndikimit dhe vlerësimi i zbatimit të akteve ligjore të rëndësishme të hartuara dhe të publikuara	Tendencë në rritje	80%	Tendencë në rritje	Arritur	
2b. Përqindja e akteve ligjore të cilat kanë kaluar përmes një procesi të gjerë konsultimesh publike dhe provat e përfshirjes së publikut dhe palëve të interesuara në proces	65.78% *	81.62%	Tendencë në rritje	Vlera në rritje krahasimisht me 2021	
2c. Numri i akteve ligjore të ndryshuara brenda vitit të parë të miratimit	10 në 2015	0	Tendencë në ulje	Arritur	
3a Përqindja e raporteve të monitorimit dhe vlerësimit për strategjitë e rëndësishme të hartuara dhe të publikuara në baza vjetore.	10%	34%	Tendencë në rritje (vlera për 2021)	Arritur	
3c. Numri i konsultimeve publike/prezantimeve të organizuara për të diskutuar raportet e monitorimit dhe vlerësimit.	4	21	Tendencë në rritje (vlera për 2021)	Arritur	

Rezultatet e arritura në 2022:

Përgjatë viteve, RAP ka qenë gjithmonë në vëmendjen e qeverisë, pjesë e portofolit të Kryeministrit dhe Zëvendëskryeministrit si dhe duke filluar nga Qershori 2022, Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve iu ngarkua përgjegjësia për përmbushjen e parimeve të mirëqeverisjes.

Qeveria shqiptare është angazhuar të ndërmarrë vendimet e duhura strategjike dhe për këtë arsye janë ngritur strukturat që harmonizojnë proceset administrative dhe shërbejnë si urë lidhëse ndërmjet nivelit politik dhe teknik.

Tashmë është i konsoliduar kuadri strategjik i RAP dhe janë të mirëpërcaktuara fushat prioritare, në linjë me standardet evropiane dhe që mundësojnë një mirëfunksionim të administratës publike.

Prej vitesh, Shqipëria ka një kuadër strategjik të mirëpërcaktuar të Reformës në Administratën Publike e cila përfshin 5 strategji: (i) Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike; (ii) Strategjinë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore; (iii) Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike; (iv) Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit dhe (v) Strategjinë Ndërsektoriale Agjenda Digjitale e Shqipërisë.

Për më tepër kuadri strategjik i RAP bazohet në dokumentin bazë strategjik - Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), në të cilën përcaktohen vizioni, prioritetet dhe objektivat strategjike sektoriale për një periudhë 5-vjeçare.

Ministri i Shtetit për Shërbimet dhe Standardet, si anëtar i përhershëm i KPS-së, drejton Grupin e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) për Mirëqeverisjen dhe RAP, gjatë së cilit sigurohet koordinimi për Agjendën e RAP. GMIP për Mirëqeverisjen dhe RAP përfshin disa Grupe Tematike, që mbulojnë disa komponentë kryesorë të RAP si: (i) Politikëbërja; (ii) Reforma në shërbimin civil dhe SNRAP; (iii) Shërbimet Publike; (iv) Qeverisja Elektronike dhe Digjitalizimi; (v) Statistikat; (vi) Anti-Korrupsioni; (vii) Decentralizimi dhe Zhvillimi Rajonal; si dhe (viii) Menaxhimi i Financave Publike.

Gjithashtu nga pikëpamja e organizimit institucional janë në funksion një sërë strukturash kyçe për të siguruar koordinimin e politikave në një nivel më teknik.

Gjatë vitit 2022 është punuar për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 (SKZHIE III) përmes koordinimit nga SASPAC dhe angazhimit të institucioneve shtetërore, ministrive të linjës, institucioneve të pavarura, agjencive zbatuese të politikave sektoriale, përfaqësues të qeverisjes vendore dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm. SKZHIE 2030 është dokumenti kryesor strategjik që përcakton vizionin për zhvillimin e demokracisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit në rrugën e integritit në Bashkimin Evropian, përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në funksion të arritjes së synimeve të Agjendës 2030. Draft-dokumenti strategjik SKZHIE III është publikuar në datë 31 Tetor 2022 në faqen zyrtare të Regjistratit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) me qëllim mbledhjen e rekomandimeve dhe komenteve nga palët e interesuara mbi adresimin e sfidave të progresit dhe integritit evropian, orientimin e reformave të vendit në nivel afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe pasurimin e këtij dokumenti me opinionet publike mbi reformat dhe përparësitë strategjike të vendit.

Një rol të rëndësishëm në koordinimin e politikave ka dhe Sekretariati i Përgjithshëm Teknik i Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave, mekanizëm kyç ky i vendosur për të bashkërenduar midis institucioneve qeveritare në këtë aspekt.

Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS), si niveli më i lartë i vendimmarrjes i drejtuar nga Kryeministri, që mbështetet në nivel teknik nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) ka funksionuar rregullisht. Në mbledhjet e KPS-së janë diskutuar tema të rëndësishme në lidhje me: (i) përcaktimin e kuadrit makroekonomik dhe fiskal të qeverisë; (ii) përcaktimin e prioritetëve të qeverisë; (iii) përcaktimin e prioritetëve të politikave dhe investimeve publike; (iv) tavanet e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm; dhe (v) investimet me rëndësi të veçantë për Shqipërinë.

Gjatë vitit 2022, KPS ka miratuar vizionin, objektivat, afatet, kalendarin e përgatitjeve për 17 strategjitë ndërsektoriale dhe sektoriale, ndër të cilat 6 strategji janë miratuar dhe 11 janë në proces miratimi.


Në terma të përgjithshëm Plani i Veprimit 2018-2022 parashikon realizimin e 34 nënaktiviteve të cilat duhet të zbatoheshin nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes.

Me riorganizimin aktivitetet janë shpërndarë dhe janë përgjegjësi e institucioneve sipas funksioneve dhe përgjegjësi.

Duhet theksuar se nga totali i **34 masave** janë realizuar plotësisht **26 prej tyre, 6 janë realizuar pjesërisht** dhe dy masa do të vijojnë të jenë relevante dhe në strategjinë e re si prioritete të identifikuara për periudhën në vijim.

Për më tepër ReSPA gjatë vitit 2022 ka mbështetur organizimin e disa aktiviteteve në drejtim të rritjes së kapaciteteve të stafit në fusha të tjera të politikëbërjes, cilësisë së legjislacionit dhe integritimit:

- kështu është mbledhur në muajin Mars 2022 [Rrjeti Rajonal i Koordinatorëve](#) për të diskutuar mbi ngritjen e akademisë për trajnimin e koordinatorëve duke kulmuar me mbajtjen [e sesionit të parë të akademisë](#) mbi proceset e Politikëbërjes të mbajtur në tetor të 2022;
- është zhvilluar trajnimi [mbi çështje të vlerësimit të ndikimit rregullator](#) dhe konsultimit publik gjatë muajit nëntor 2022; dhe mbi [Kornizën e Përbashkët të Vlerësimit](#) si një instrument që mbështet institucionet e administratës publike për të matur performancën. Cikli i trajnimeve është zhvilluar gjatë muajve Mars, Qershor, Shtator dhe Dhjetor 2022;
- një tjetër fushë dhe prioritet në zhvillimin e kapaciteteve ka qënë dhe **përgatitja për procesin e negociatave**. Për këtë qëllim në datat 09 - 13 maj, profesionistë të nivelit të lartë dhe të mesëm nga vendet anëtare të ReSPA të përfshirë në negociatat e anëtarësimit dhe procesit të integritimit evropian ndoqën [shkollën sezonale për Negocimin e Anëtarësimit në BE](#). Gjatë 5 ditëve intensive, përfaqësues të administratës publike u njohën nga afër me përvojat praktike në lidhje me kapitujt e anëtarësimit dhe të fushave ku duhet të përafrohet legjislacioni me BE-në.



Komponenti i konsultimit publik mbi projekt-iniciativat ligjore dhe të politikave është konsideruar si një tregues i rëndësishëm i monitoruar nga SIGMA, pjesë e raport-progresit të Komisionit Evropian në kuadër të Reformës së Administratës Publike por dhe instrument i rëndësishëm i lidhur me llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë.

Tashmë programimi vjetor i akteve rregullatore dhe nismave prioritare, Vlerësimi i Ndikimit Rregullator, konsultimi publik dhe monitorimi i zbatimit të kuadrit ligjor funksionojnë të qendëruara.

Nga qershori i vitit 2022, konsultimi publik është në përgjegjësinë e Departamentit Rregullator dhe Përputhshmërisë, duke e lidhur atë me funksionet themelore të sistemit të politikëbërjes dhe që lidhen ngushtësisht me arritjen e një qeverisje transparente, efektive dhe llogaridhënëse.

Treguesit kryesorë gjatë 2022:

Në lidhje me treguesit e performancës për vitin 2022, procesi i konsultimit publik paraqitet i konsoliduar në zbatim të standardeve dhe parimeve të procesit të parashikuar në udhëzuesin për konsultimin publik.

- Indeksi i frekuencës së konsultimeve publike për vitin 2022 është 81,63% ndërsa cilësia është vlerësuar me 6,34 pikë nga 7 maksimale;
- rritur numri i grupeve të interesit të përfshirë në takimet konsultative - rreth 2313 pjesëmarrës nga të cilët 477 kanë kontribuar me komente;
- 70% e komenteve të mbledhura nga procesi i konsultimit publik janë pranuar dhe janë reflektuar në draftin final të legjislacionit të hartuar.

Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë në kuadër të këtij funksioni të ri do të vijojë të synojë përmirësimin e procesit të konsultimit publik duke synuar:

- rritjen e funksionalitetit të Regjistrisë Elektronike të Njoftimit dhe Konsultimit publik për ta bërë atë më dinamik;
- rritjen e përfshirjes së aktorëve të interesit në proces, nëpërmjet ndërmarrjes së procesit të identifikimit dhe mundësimin të njoftimeve automatike lidhur me procesin e konsultimit publik; dhe
- shtrirjen për herë të parë të procesit të standardizuar të konsultimit publik edhe në Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Në kuadër të procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA), zbatimi i metodologjisë dhe zhvillimi i trajnimeve ka ndikuar në rritjen e cilësisë dhe efektivitetin e hartimit të politikave/legjislacionit në Shqipëri duke bërë të mundur që ndërhyrja e qeverisë të jetë e drejtuar aty ku është e nevojshme.

Një prej rekomandimeve të lëna nën këtë shtyllë gjatë raportit të monitorimit të SNRAP për 2021 është dhe kryerja e trajnimeve nga ana e trajnerëve (ToT) për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme ndaj zbatimit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA), rekomandim ky i ndjekur gjatë gjashtëmuajorit të parë të 2022. Në trajnimin pesëditor të organizuar në muajin mars, mbi aspektet teorike dhe praktike të metodologjisë së vlerësimit të ndikimit, koordinatorët e Njësive RIA patën mundësinë të aplikojnë në praktikë njohuritë e fituara nga ToT duke përgatitur kurrikulën dhe duke organizuar një prej seancave trajnuese. Në total, në të 5 seancat e trajnimit morën pjesë rreth 40 anëtarë të rrjetit RIA nga ministrinë e linjës. Ndërsa më datë 5 korrik 2022, me ndihmën e OECD/SIGMA, u zhvillua seanca trajnuese mbi aspektet praktike të raporteve të vlerësimit të ndikimit në proces hartimi nga institucionet përgjegjëse, në të cilën morën pjesë rreth 20 koordinatorë të rrjetit RIA.

Tregues kryesorë gjatë 2022:

- hartuar dhe rishikuar nga Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri, **56** raporte RIA;
- monitoruar zbatimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2022 ku përqindja totale e realizimit të Planit Analitik 2022 është **71%**;
- cilësia e analizës së vlerësimit të ndikimit dhe vlerësimi i zbatimit për aktet ligjore të rëndësishme të hartuara dhe të publikuara në nivelin mbi 80%;
- monitoruar ndryshimet e legjislacionit për 74 ligje/akte normative ku **asnjë prej tyre nuk ka bërë ndryshime** në një akt ligjor/normativ të miratuar brenda harkut kohor të 12 muajve që i paraprijnë miratimit të vetë ligjit⁶.

Masat të cilat janë parashikuar për zbatim nga Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë janë 10 në total. Nga këto **8 janë realizuar plotësisht dhe dy masa pjesërisht.**

⁶ Duhet theksuar se nga kjo llogaritje janë përjashtuar aktet ligjore/normative të miratuara për arsye të paparashikueshme të cilat lidhen me procesin e rindërtimit apo masat e marra për të përballuar situatën e krijuar si pasojë e vështirësive energjitike apo ekonomike.


Promovimi i kulturës organizative në shërbimin civil ka qenë në fokus të programit të qeverisë për reformimin e mëtejshëm të shërbimit civil, një komponent i zhvilluar përmes zbatimit të programit "Administrata që duam", të nisur në vitin 2018.

Aktivitetet e ndryshme të këtij programi janë zbatuar për përmirësimin e performancës së nëpunësve civilë dhe institucioneve të administratës shtetërore, me qëllim zhvillimin e një kulture të fortë administrative të fokusuar në energjizimin e administratës publike nëpërmjet orientimit, trajnimit, motivimit dhe ndërveprimit, duke rezultuar në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët.

Në drejtim të rritjes së ndërveprimit të administratës, funksionojnë shtatë rrjete profesionale të cilat synojnë të nxisin bashkëpunimin dhe diskutimet rreth sfidave kryesore dhe temave të një rëndësie të veçantë në sektorët përkatës.

Gjithashtu, shumë i vlefshëm ka rezultuar përdorimi i platformës së integruar "administrata.al" në drejtim të (i) përmirësimit të ndërveprimit ndërmjet institucioneve publike; (ii) lehtësimit të komunikimit dhe raportimit të informacionit në kohë reale; (iii) unifikimit të praktikave administrative dhe; (iv) përmirësimit të cilësisë së proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore.

ADMINISTRATA QË DUAM



Duke pasur gjithmonë në qendër rritjen e performancës në institucionet publike, qeveria shqiptare i ka kushtuar një vëmendje të veçantë promovimit të ekselencës si në aspektin e energjizimit të administratës por edhe promovimin e një kulture organizative ku janë të mirëpritura idetë dhe projektet e reja.

I tillë është rasti i krijimit të qendrave të ekselencës dhe programit "Gati për Shqipërinë", një program që synon që individë të ndryshëm të diplomuar jashtë dhe brenda vendit të punësohen duke kontribuar me ide, projekte dhe iniciativa të ndryshme zhvillimore.

Gjatë vitit 2022 u ofruan sipas procedurës gjithsej 149 pozicione pune nga të cilat 118 pozicione të shërbimit civil dhe 31 pozicione me kod pune. Gjithsej në 2022 ka patur (i) 527 aplikantë (190 aplikantë nga platforma "Gati për Shqipërinë" dhe 337 të diplomuar); (ii) 333 të kualifikuar (62 të kualifikuar nga platforma "Gati për Shqipërinë" dhe 271 të diplomuar); 99 aplikantë u emëruan në pozicione pune, në institucionet e administratës shtetërore (42 nga platforma "Gati për Shqipërinë" dhe 57 të diplomuar ekselentë).

Nën këtë shtyllë DAP ka vetëm dy masa të cilat janë realizuar në nivelin 100%.

Masat: përgatitja dhe përditësimi i formateve standarde për funksionimin e grupeve të punës për programin "Administrata që duam" dhe monitorimi i zbatimit të Planit të Ekzekutimit të Programit "Administrata që duam" do të vijojnë të mbeten relevante dhe në periudhën në vijim duke i dhënë kështu rëndësinë e duhur vazhdueshmërisë së zbatimit të këtij programi që ka dhënë shumë kontribut në ndërtimin e një administrate efçente dhe efikase.

Sfida dhe rekomandime:

- Forcimi i qasjes për hartimin dhe zhvillimin e politikave sektoriale mbështetur në të dhëna cilësore dhe rritja e kapaciteteve monitoruese e vlerësuese për to.
- Përmirësimi i sistemit IPSIS, thjeshtimi i përdorimit të tij.
- Shtrirja dhe përdorimi i sistemit IPSIS nga institucionet.
- Funksionimi i qasjes së menaxhimit të integruar ndërsektorial të administrohet edhe në IPSIS.
- Përmirësimi i planifikimit dhe kostimit të dokumentave strategjike, lidhja me Programi Buxhetor Afatmesëm.

Për të përmirësuar cilësinë e raporteve të RIA-s mbetet prioritet:


- Krijimi i një moduli trajnimi të vazhdueshëm për anëtarët e rrjetit RIA. Trajnimet për RIA të jenë pjesë e kurrikulës standarde të trajnimit për nëpunësit civilë.
- Shtrirja e procesit RIA dhe në aktet nënligjore.
- Sa i përket masave për rritjen e cilësisë së procesit të **Konsultimit Publik (KP)**, prioritare mbetet rritja e efektivitetit të përdorimit të platformës së konsultimit publik, nëpërmjet: shkrimit dhe publikimit të raporteve individuale në KP përpara miratimit të aktit;
- përforcimit të rolit të koordinatorit për konsultimin publik;
- bërja e procesit të Konsultimit Publik pjesë e planifikimit të hershëm.
- respektimi i afateve në procesin e konsultimit publik.

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Politikat nën këtë shtyllë synojnë rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj publikut dhe përafrimin më të shpejtë me standartet dhe kërkesat e BE-së nëpërmjet përdorimit të mjeteve inovative dhe sporteve unike. Gjithashtu synohet përmirësimi i mënyrës së funksionimit dhe organizimit të administratës publike nëpërmjet fuqizimit të strukturave institucionale.


Shtylla II "Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike" parashikon realizimin e 18 nën-aktiviteteve nga të cilat janë realizuar plotësisht 14 nën-aktivitete ose 78%.

Statusi i realizimit të qëllimit politik: Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike



■ Realizuar plotësisht ■ Realizuar pjesërisht

Statusi i realizimit të produkteve sipas objektivave



■ Realizuar plotësisht ■ Realizuar pjesërisht

Lista e të gjithë indikatorëve me vlerën bazë, vlerën e matur dhe vlerën e synuar në 2022

Indikatorët	Vlera Bazë	Vlera e matur në 2021	Vlera e synuar për 2022	Trendi (tendencë në ulje/tendencë në rritje/ arritur)	
5a. Numri i shërbimeve të qeverisë qendrore me ndërveprim të përmirësuar në zyrat e pritjes	300	1209	Sherbimet nga 1 Maji ofrohen online	Arritur	
5b. Numri i zyrave me një ndalesë, të ngritura në njësitë e qeverisjes vendore	1 pilot	Në 100% të bashkive	Sherbimet nga 1 Maji ofrohen online	Arritur	

Rezultatet e arritura në 2022:

Në kuadër të zbatimit të objektivave të parashikuara në planin e veprimit të SNRAP 2018-2022 për të kryer një reformë strukturore të institucioneve të varësisë u ngritën strukturat udhëheqëse, komiteti drejtues, grupi i menaxhimit, grupi qëndror i punes, grupet teknike të punës pranë ministrive. Komiteti drejtues i reformës strukturore të institucioneve të varësisë ka miratuar në 2018 dokumentin e përgjithshëm të tipologjisë së institucioneve të varësisë. Bazuar në vendimin e këtij komiteti u krye dhe pilotimi i metodologjisë së SIGMA për tre sisteme, atë të shëndetësisë, arsimit dhe aparatit e turizmit dhe mjedisit.

Gjatë këtij procesi DAP-i është mbështetur nga projekti i asistencës teknike të Delegacionit të BE-së në Shqipëri, “Mbështetje për reformën e institucioneve të varësisë dhe agjencive në Shqipëri”, i cili prek tipologjinë e institucioneve dhe linjën e tyre të raportimit si dhe është mbështetur nga projekti IPA “Zbatimi i Reformës së Shërbimit Civil në Administratën Publike”, për hartimin e proceseve horizontale dhe vertikale të punës në ministritë e linjës.

Tipologjia e institucioneve parashikohet në Ligjin nr. 90/2012⁷ ku përcaktohet se përveç administratës së prefektit, përfshihen: i) institucionet e varësisë; ii) agjencitë autonome; iii) njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve. Këto institucione sigurojnë zbatimin e politikave, nëpërmjet funksioneve rregullatore dhe të ofrimit të shërbimeve.

Kuadri rregullator e centralizon funksionin e përgatitjes së strukturës dhe organikës së institucioneve të administratës shtetërore në një institucion të vetëm, duke ia dhënë këtë kompetencë DAP-it dhe atë të miratimit Kryeministrit.

Nga ana tjetër, konsultimi dhe marrja e mendimit nga ministria përgjegjëse për financat në lidhje me strukturat dhe organikat e institucioneve, është e detyrueshme. Edhe në rastet kur mbështetur në një ligj të veçantë struktura organizative nuk miratohet nga Kryeministri, meritë në mënyrë të detyrueshme mendimi i DAP-it dhe ministrisë përgjegjëse për financat.

Pas 10 vitesh zbatimi të ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, analizat dhe rekomandimet e bëra nga SIGMA/OECD, si dhe nga projekti “Mbështetje për reformën e institucioneve të varësisë dhe agjencive në Shqipëri”, një nga çështjet të cilat janë evidentuar për ndërhyrje të mëtejshme është çështja që lidhet me **tipologjinë e institucioneve të administratës shtetërore**.

Për këtë qëllim, **ligji 90/2012 do t'i nënshtrohet një procesi ndryshimesh** për përcaktimin më të mirë të organizimit, funksioneve, tipologjive të institucioneve dhe linjës së llogaridhënies duke përfshirë mbikëqyrjen e institucioneve të varësisë.

Gjatë vitit 2022, DAP ka nisur punën për hartimin e projektligjit për ndryshimin e ligjit nr. 90/2012, i cili është ligji kuadër në fushën e krijimit, organizimit dhe funksionimit të institucioneve të administratës shtetërore. Nëpërmjet këtij projektligji synohet:

- të bëhen disa rregullime përsa i përket tipologjisë së institucioneve të administratës shtetërore;
- të përcaktohet mekanizmi i mbikëqyrjes së performancës së institucioneve të administratës shtetërore si dhe raportimi në Këshillin e Ministrave në lidhje me zbatimin e ligjit.

Një draft i parë është në përgatitje e sipër, bazuar në rekomandimet e projekteve të sipërcituara dhe synohet që këto ndryshime të miratohen gjatë vitit 2023.

Përveç sa më sipër gjatë vitit 2022 puna është fokusuar në drejtimet si vijon:

▪ **ndryshime të strukturave dhe organikave të institucioneve:**

Janë kryer ristrukturimet e disa institucioneve të varësisë dhe konkretisht:

- Qendra Kombëtare e Biznesit;
- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural;
- Shërbimi Social Shtetëror në Nivel Qëndror;
- Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara;
- Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial;
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
- Shërbimi i Gjendjes Civile;
- Drejtoria e Përgjithshme Detare;
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.

⁷ “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”

Në total janë kryer 44 ristrukturime të ministrive të linjës/institucioneve në varësi të ministrave si dhe janë miratuar strukturat për 6 institucione të reja.

- **riorganizime të institucioneve**

- Në vijim të programit të ristrukturimit në përputhje me politikën e qeverisë, mbi bazën e strategjisë së hartuar për këtë qëllim dhe në funksion të mbështetjes së saj me bazën ligjore të nevojshme dhe rregullimet ligjore të duhura, gjatë këtij viti janë analizuar, vlerësuar dhe reflektuar sistemet ministrore sa më poshtë:

- **për sistemin e Kryeministrit:**

- ristrukturuar aparati i Kryeministrit në zbatim të VKM-së nr. 517/2022, në bazë të të cilit u krijua pozicioni i “Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator” si dhe për shkak të zëvendësimit të postit të “Zëvendëskryeministër dhe Ministër Shteti për Rindërtimin dhe Programin e Reformave” me postin “Zëvendëskryeministër”;
- miratuar struktura dhe organika e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje⁸;
- miratuar struktura dhe organika e Komitetit për Pakicat Kombëtare, i cili është përgjegjës për sigurimin e mbrojtjes dhe të promovimit të të drejtave dhe interesave të pakicave kombëtare⁹;
- miratuar kalimi i funksioneve të bashkëpunimit territorial dhe e koordinimit të programeve kombëtare dhe rajonale të IPA-s nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme tek SASPAC¹⁰;
- miratuar struktura e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit duke vlerësuar rëndësinë e proceseve që realizohen nëpërmjet programeve të teknologjisë së informacionit si dhe për të forcuar mbrojtjen e infrastrukturës dhe sistemeve nga sulmet kibernetike.

- **për sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:**

- krijuar Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, në varësi të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për të cilën është miratuar edhe struktura dhe organika e institucionit¹¹.

- **për sistemin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë**

- miratuar struktura dhe organika e kësaj ministrie¹²;
- kalimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit nga institucion varësie në aparatin e ministrisë;
- miratuar struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë.

- **për sistemin e Ministrisë së Brendshme**

- ristrukturimi i kësaj ministrie;
- miratuar struktura e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- miratuar struktura e Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara.

- **për sistemin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë**

- miratuar ndryshimi i strukturës dhe organikës së kësaj ministrie dhe shtuar funksionet administrative në fushën e rindërtimit;
- miratuar struktura dhe organika e Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë dhe Operimin në Aviacionin Civil;
- krijuar Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare;
- krijuar Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore.

- **Për sistemin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit**

- miratuar struktura dhe organika e kësaj ministrie dhe e disa prej institucioneve të varësisë: (i) Agjencia Kombëtare e Mjedisit; (ii) Agjencia Kombëtare e Bregdetit; (iii) Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe; (iv) Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

24 8 Në zbatim të VKM-së nr. 526, datë 29.7.2022, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje”.

9 Në zbatim të VKM-së nr.726, datë 12.12.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit për Pakicat Kombëtare”.

10 Bazuar në VKM-në nr.642, datë 29.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik

11 Në zbatim të VKM nr. 637, datë 27.10.2021, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror”.

▪ **Për sistemin e Ministrisë së Drejtësisë**

- miratuar struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me qëllim përshtatjen e sistemit të burgjeve me hartën e re të sistemit gjyqësor.

Nën këtë shtyllë DAP është përgjegjës për zbatimin e tre masave (4.1.1, 4.1.2 dhe 4.1.3). Të tre masat janë realizuar plotësisht.

Në zbatim të vendimit nr. 252 datë 29.04.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve online nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre” duke filluar prej datës 1 maj 2022 të gjitha shërbimet publike ofrohen online.

Nën këtë shtyllë DAP është përgjegjës për zbatimin e tre masave (4.1.1, 4.1.2 dhe 4.1.3). Të tre masat janë realizuar plotësisht.

Stafi i Zyrës Qëndrore të Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për realizimin e disa detyrave lidhur me ofrimin e shërbimeve” po bashkëpunon me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB) për:

- monitorimin e zbatimit të afateve të përdorimit të Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE), në rastet kur duhet të ketë shkëmbim dokumentacioni shoqërues ndërmjet institucioneve, deri në marrjen e shërbimit e të dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik nga qytetarët dhe subjektet sipas afateve ligjore, si dhe;

- ndjekjen e ecurisë së ankesave të administruara nga ADB-ja për mënyrën e ofrimit të shërbimeve nga institucionet shtetërore në nivel qarku.

Në këtë kuadër është përgatitur urdhri i përbashkët i dy agjencive për organizimin e punës dhe hapat që do të ndiqen në bashkëpunimin ndërmjet tyre.

Në zbatim të urdhrin nr.2, datë 19.01.2022, të Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e pasaportës, platformës dhe metodologjisë dhe bashkërendimin me institucionet e tjera për monitorimin e implementimit të standardeve të shërbimeve” si dhe Urdhërit nr.239, datë 04.03.2022 “Për ngritjen e grupeve të Punës”, gjatë periudhës raportuese vijoi procesi i identifikimit të standardeve të institucioneve shërbimofruese dhe krijimit të *Metadata* dhe Barometrit të cilësisë së shërbimeve publike.

Për arritjen e këtij objektivi u ngritën grupet e punës me qëllim asistimin e punonjësve të institucioneve publike në plotësimin e pyetësorëve në nivel institucioni dhe shërbimi, për 11 institucione të përfshira në fazën e pilotimit.

Në secilin institucion u përzgjedhën një kampion shërbimesh ku janë përfshirë kategoritë kryesore, të dhënat e të cilëve do të shërbejnë për të ndërtuar një model për matjen e nivelit të cilësisë së shërbimeve sipas indikatorëve/indeksit të përcaktuar.

Në përfundim do të hartohet barometri dhe pasaporta e standardeve si dhe do të monitorohet zbatimi i këtyre të fundit, si një nga prioritetet e Qeverisë Shqiptare.



Nga analiza e procesit të monitorimit të zbatimit të 5 aktiviteteve e 13 nën aktiviteteve rezulton që janë implementuar plotësisht 10 nën-aktivitete dhe pjesërisht 3 nën-aktivitete.

Me riorganizimin dhe funksionet e reja të ADISA do të lindë nevoja për shkrimin e aktiviteteve të reja të cilat do të mundësojnë realizimin e reformave të qeverisjes në drejtim të ofrimit të shërbimeve online.

Nën këtë shtyllë gjithashtu janë parashikuar dhe disa aktivitete të cilat zbatohen nga Agjencia për Mbështetjen dhe Vetëqeverisjen Vendore:

Publikimi i udhëzimeve për menaxhimin e burimeve njerëzore mbi politikat dhe praktikat në nivel lokal

Adoptimi i formateve standarde për përshkrimin e punës, procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të performancës bazuar në Toolkit për menaxhimin e burimeve njerëzore

Zbatimi i procesit të arkivimit fizik të dokumentacionit në secilën bashki

Rritja e kapaciteteve institucionale për përfshirjen dhe konsultimin e publikut

Pilotimi i sistemit online për ofrimin e shërbimeve administrative të bashkive (lidhja e sistemeve front office me back office duke ndërlidhur në një sistem të vetëm njësitë administrative me njësitë qendër)

Nga këto pesë aktivitete janë realizuar plotësisht 4 prej tyre dhe pjesërisht është realizuar aktiviteti “rritja e kapaciteteve institucionale për përfshirjen dhe konsultimin e publikut”, aktivitet i cili është përkthyer si sfidë dhe i cili mund të jetë relevant dhe për periudhën në vijim.

AMW në bashkëpunim me projektin STAR2, ka mundësuar adoptimin e 37 procedurave standarde operacionale (PSO). Pas vlerësimit paraprak mbi nevojat për përmirësim të SPO-ve në bashkitë e vendit, u hartuan kurrikulat e trajnimit mbi Kodin e Procedurave Administrative (KPA) dhe adoptimin e Procedurave Standarde Operacionale në nivel lokal, të cilat u çertifikuan nga ASPA. Bazuar në këto kurrikula, u krye një cikël i plotë trajnimesh që përfshin 14 sesione dy ditore mbi KPA dhe PSO. Rreth 195 zyrtarë vendorë me pjesëmarrje pothuajse nga të gjithë bashkitë (57 nga 61), morën pjesë në këto trajnime. Mbështetja për këtë sektor vazhdoi me asistencën në vendin e punës për zhvillimin dhe adoptimin e PSO mbi buxhetin, prokurimin dhe burimet njerëzore në 9 bashki të përzgjedhura (Krujë, Skrapar, Berat, Kuçovë, Lezhë, Shkodër, Fushë Arrëz, Elbasan dhe Gramsh). Modeli i zhvilluar është shpërndarë dhe diskutuar në bashki të tjera.

Sfida dhe rekomandime:


- Kuadër i qartë ligjor sa i përket tipologjisë së krijimit të institucioneve të administratës shtetërore.
- Krijimi i kuadrit rregullator dhe mekanizmave të duhur lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e performancës së institucioneve të varësisë nga institucionet qendrore.
- Ngritja dhe funksionimi i sistemit të vlerësimit të performancës institucionale.
- Vijimi i procesit të rishikimit dhe ri-inxhinierimit të mënyrës sesi institucionet e administratës ofrojnë shërbimet publike, si masë e domosdoshme për thjeshtimin e procedurave administrative dhe reduktimin e kohës së marrjes së shërbimit të kërkuar;
- Përfshirja e të gjithë institucioneve që ofrojnë shërbime në platformë në SQDNE;
- Realizimi i inspektimeve periodike për institucionet për të identifikuar aplikimet që vonohen ose dorëzohen me gabime, bazuar në rezultatet e monitorimit të platformës SQDNE dhe ankesave përkatëse të qytetarëve përmes platformës së bashkëqeverisjes.

SHËRBIMI CIVIL: MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE


Politikat nën këtë shtyllë synojnë rritjen e kapaciteteve, transparencës dhe përgjegjshmërisë për zbatimin në mënyrë të unifikuar të legjislacionit të shërbimit civil në të gjitha nivelet si dhe rishikimin e përmirësimin e sistemit të pagave në shërbimin civil.

Shtylla III “Shërbimi Civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore” parashikon realizimin e 36 nën-aktiviteteve nga të cilat 35 nën-aktivitete kanë filluar të zbatohen. Nga këto 28 nën-aktivitete janë realizuar plotësisht dhe 7 janë realizuar pjesërisht dhe 1 është nënzbaturim në TM I-rë 2023.

Statusi i realizimit të qëllimit politik
Shërbimi Civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore



Statusi i realizimit të produkteve sipas objektivave



Lista e të gjithë indikatorëve me vlerën bazë, vlerën e matur dhe vlerën e synuar në 2022

Indikatorët	Vlera Bazë	Vlera e matur në 2022	Vlera e synuar për 2022	Trendi (tendencë në ulje/tendencë në rritje/ arritur)	
6a. Qarkullimi vjetor (lëvizja paralele) e stafit të nivelit drejtues në të gjitha nivelet e shërbimit civil në institucionet e administratës qendrore	8.00%	7.52%	Tendencë në rënie	Arritur	
6b. Numri mesatar i pjesëmarrësve në një procedurë rekrutimi për rekrutim nga jashtë dhe nga brenda (transferim) në shërbimin civil	6b.1 13.1 për 2015 dhe 6.b2 1.3 2015	6b1 27.2/6b2 5.78	Tendencë në rritje	Arritur	
6c. Numri i ankesave që kanë të bëjnë me rekrutimin në shërbimin civil të pranuar nga gjykata (duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2014) ka shënuar rënie	3	0%	Tendencë në rënie	Arritur	
7b. Rritja e variacionit/ numrit të pozicioneve në skemën e pagave bazuar në përshkrimin e punës	Rritje, me të paktën 3 nivele	Do të matet pas miratimit të dokumentit të pagave	Rritje, me të paktën 3 nivele	Do të matet pas miratimit të dokumentit të pagave	

Rezultatet e arritura në 2022:

Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore është një nga komponentët kryesorë dhe me ndikim të lartë në zbatimin e një reforme gjithëpërfshirëse në administratën publike.

Kërkesat drejt rrugës së Integritimit Evropian diktojnë domosdoshmërinë për patur burime njerëzore të afta për të çuar përpara reformat, duke garantuar praktika të rekrutimit bazuar në meritë, motivuar dhe siguruar

qëndrueshmëri të profesionistëve në administratën publike si dhe duke forcuar kapacitetet e tyre mbi aplikimin e unifikuar të legjislacionit të shërbimit civil.

Fokusi kryesor i punës në këtë drejtim ka qenë kryerja e një analize të legjislacionit të shërbimit civil; mbikëqyrjes së zbatimit të akteve ligjore në SHC; forcimit të kapaciteteve të DAP dhe strukturave të menaxhimit të burimeve njerëzore; rritjes së efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë; shtrirjes së bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë për të përthithur studentët më të mirë në administratën publike; rritjes së nivelit të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore; dhe trajnimit të vazhdueshëm të NC.

Treguesit kryesorë në lidhje me fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

- Numri i stafit drejtues të larguar gjatë vitit 2022 është 78 nga totali i stafit drejtues prej 1037 dhe shënon vlerën 7.5%;
- Në total 15697 pjesëmarrës nga jashtë shërbimit civil kanë marrë pjesë në procedurat e rekrutimit në 576 pozicione të shpallura në kategorinë ekzekutive, duke rezultuar në një numër mesatar pjesëmarrësish prej 27.2;
- Në total 3331 pjesëmarrës nga brenda shërbimit civil kanë marrë pjesë në proceset e rekrutimit¹³ për 576 procedura, duke rezultuar në një numër mesatar pjesëmarrësish prej 5.78, një vlerë më e lartë se baseline. Trendi rritës i këtij indikator tregon se një ndër rritje të legjislacionit të shërbimit civil, ai i mobilitetit, është gjithnjë e më shumë në zbatim, duke i dhënë shërbimit civil dinamizëm dhe energji të reja.
- Sa i takon numrit të ankesave që kanë të bëjnë me rekrutimin në shërbimin civil, të pranuar nga gjykata (duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2014), për vitin 2022 nuk ka pasur asnjë ankesë të pranuar nga gjykata Administrative e Apelit në lidhje me procedurat e rekrutimit.

Numri i ulët (pothuajse 0) i ankesave të pranuar nga gjykata Administrative e Apelit edhe gjatë vitit 2022 tregon zbatim rigoroz të legjislacionit përkatës për rekrutimin e nëpunësve civilë duke përfshirë këtu Ligjin nr.152 për “Nëpunësin Civil” dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, për organizimin e procedurave transparente në mënyrë profesionale dhe bazuar në meritë.

Bazuar në rekomandimet e lëna nga Kuvendi në rezolutën për zbatimin e legjislacionit për nëpunësin civil si dhe në analizën e bërë ndër vite në lidhje me legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, gjatë gjashtëmujorit të parë DAP ka filluar punën për përgatitjen e projektligjeve përkatëse, e konkretisht:

- Në bashkëpunim me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është krijuar një grup i përbashkët pune, i cili identifikoi problematikat dhe ndërhyrjet e nevojshme.

Diskutimet për hartimin e projektligjit për ndryshimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, kanë vijuar dhe synohet të realizohen rregullime në lidhje me:

- kriteret e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil;
- afatin e pezullimit të nëpunësve civilë që zgjidhen si anëtarë të këshillave bashkiakë;
- rastet e lirimit nga shërbimi civil, ristrukturimit, pezullimit, ecurisë disiplinore, etj;
- zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
- procesin e vlerësimit të punës së nëpunësve civilë;
- kriteret për përparimin në hapat e pagës;
- organizimin dhe funksionimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).

Dy projektligjet (ligji nr. 152/2013 dhe ligji nr. 90/2012) janë akte të rëndësishme që mbulojnë fusha që lidhen me dy parimet kryesore të administratës publike, atë të shërbimit civil dhe menaxhimit të burimeve njerëzore dhe llogaridhënies dhe këto dy ligje kanë qenë të përfshira edhe në rekomandimet e lëna nga partnerët ndërkombëtarë.

Në drejtim të rritjes së efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë po zbatohet gjatë vitit 2023 programi “Ngritja e kapaciteteve për nëpunësit civilë të administratës publike”, përfshirë trajnimet/praktikat në administratat e vendeve anëtare të BE-së dhe skemën e bursave (“qelizat e reja”)¹⁴.




Qëllimi i kësaj skeme është përzgjedhja e një organizate që do të mbështesë Qeverinë Shqiptare në reformën e shërbimit civil përmes zhvillimit dhe zbatimit të programit të trajnimit dhe internship-it dedikuar nëpunësve civilë të rinj. Kjo skemë do të kontribuojë në zhvillimin e një administratë publike eficiente, efektive dhe transparente në Shqipëri.

Skema ka objektivin specifik të:

- përmirësojë kapacitetet profesionale dhe ekspertizën e nëpunësve civilë të kategorisë III dhe IV në **administratën shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore** në sektorët kyç të administratës publike duke i ofruar mundësi nëpunësve civilë të konfirmuar të marrin pjesë në **trajnime praktike dhe internship/praktika** pune në shkollat dhe administratën publike në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Kjo skemë do t’iu mundësojë nëpunësve të përmbushin detyrimet dhe sfidat të cilat diktohen gjatë procesit të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian si dhe të detyrimeve të tjera strategjike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- zhvillojë dhe zbatojë mekanizma të qëndrueshëm që mbështesin zhvillimin në karrierë të **nëpunësve civilë** që marrin pjesë në këtë skemë, duke iu mundësuar atyre të kontribuojnë në efektivitetin dhe inovacionin e administratës publike;
- ngritjen dhe promovimin e rrjetit të ndërveprimit dhe bashkëpunimit midis nëpunësve/*alumni*.

Në skemë mund të aplikojnë të gjithë nëpunësit civilë të rinj të kategorisë III dhe IV, të administratës shtetërore, institucioneve të pavarura dhe njësitë të qeverisjes vendore të cilët kanë 3-8 vjet eksperiencë në administratë publike.

Në lidhje me kryerjen e vlerësimeve 'ad-hoc' për të marrë opinionin e aplikantëve mbi procesin e rekrutimit gjatë vitit 2022, ReSPA dhe Universiteti i Nottingham në bashkëpunim me DAP kanë zhvilluar studimin mbi matjen e perceptimit të nëpunësve mbi qëndrimet dhe sjelljet e tyre në vendin e punës përfshirë matjen e motivimit, përkushtimit dhe ndërveprimit si dhe matjen e përvojës së tyre mbi praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore.



Sondazhi u shpërnda gjërësisht në disa sektorë të administratës shtetërore duke përfshirë të gjithë ministratë, institucionet e tyre të varësisë, ato të pavarura dhe nivelin vendor. Pyetësi i shpërndarë është plotësuar nga **5842 nëpunës**. Rezultatet e dalës në përfundim të studimit ishin inkurajuese ku motivimi për shërbime publike është vlerësuar më **73%**, indeksi i

14 “Capacity building for civil servants of the public administration, including trainings/internships in eu members state administrations and scholarship scheme (“young cells”)

kënaqësisë në punë **71%**, motivimi në punë **69%** dhe përkushtimi në punë në nivelin **63%**. Gjithashtu të dhënat treguan se 66% e të anketuarve shprehen se puna që kryejnë është frymëzuese.

Në lidhje me përvojën për praktikën për menaxhimin e burimeve njerëzore është evidentuar një trend pozitiv në përdorimin e faqes zyrtare të njoftimeve për punësimin të DAP dhe zhvillimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë. Në përfundim të studimit janë lënë rekomandime për të adresuar dhe rritur më tej motivimin dhe qendrueshmërinë në administratën publike.

Disa aktivitete kryesore në drejtim të sensibilizimit të publikut për tu bërë pjesë e shërbimit civil:

- Zhvilluar sesion i hapur gjatë muajit Maj pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, ku u diskutua për mënyrat e punësimit të rinjve në administratën publike, nëpërmjet rekrutimit të DAP, thirrjeve të dedikuara të ekselentëve, programit të “Praktikave Kombëtare të Punës” etj;
- Rritjes së vizibilitetit mbi thirrjet e shpallura dhe procesin duke shtrirë komunikimin me qytetarët nëpërmjet mjeteve të komunikimit koherente si: [faqja zyrtare e DAP](#), rrjetet sociale dhe kanalit [youtube](#);
- Ritur interaktiviteti-1584 numri i kërkesave për informacion nga qytetarët/aplikantët të adresuara përmes komunikimit përmes [info DAP](#).

Në vijim të rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore janë zhvilluar disa aktivitete shumë të rëndësishme si:

- organizuar nga ReSPA në Maj 2022 workshop-i për digjitalizimin e të dhënave për menaxhimin e burimeve njerëzore. Qëllimi kryesor i tij ishte për të prezantuar progresin në këtë fushë nga vendet anëtare të ReSPA, trendet dhe teknologjitë e reja dhe impakti i tyre në fushën e BNJ; Përvoja e Shqipërisë ishte një vlerë e shtuar në këtë takim në terma të prezantimit të evolimit të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, përdorimit të tij për të administruar të dhëna mbi personelin dhe ndërlidhjen për gjenerimin automatik të listëpagesave;
- ndarë me pjesëmarrësit gjatë konferencës së mbajtur për thjeshtimin e procedurave administrative në vendet e Ballkanit Perëndimor e zhvilluar në Maj 2022 në Turqi, eksperiencën e Shqipërisë mbi krijimin dhe vënien në përdorim të platformës “Administrata.al”, si dhe benefitet që sjell në drejtim të unifikimit dhe thjeshtimit të procedurave në fushën e Burimeve Njerëzore;
- zhvilluar në datat 21 dhe 22 Qershor 2022 në Serbi workshop-i mbi shkëmbimin e praktikave më të mira midis vendeve anëtare të ReSPA mbi menaxhimin e bazuar në kompetenca si dhe njohja me praktikën të cilat zbatohen në vendet e Bashkimit Evropian në lidhje me zhvillimin e procesit të rekrutimit bazuar në kompetenca dhe zhvillimin e karrierës të nëpunësve civilë;
- praktikën pozitive të DAP në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore kanë tërhequr interesin e vendeve anëtare të ReSPA për të ndarë eksperiencat mbi zhvillimet më të fundit në fushën e burimeve njerëzore.
- Në kuadër të skemës së mobilitetit si një skemë e mbështetur nga ReSPA me synimin për t'u lejuar nëpunësve publikë të fitojnë përvojë nga kontekste të ndryshme, veçanërisht në administratën publike në rajon por edhe me shtetet anëtare të BE-së, Departamenti i Administratës Publike mirëpriti gjatë muajit Qershor 2022 delegacionin nga Ministria e Administratës Publike, Shoqërisë Digjitale dhe Mediave të Malit të Zi;
- pjesëmarrjes në vizita studimore në vendet e BE (Spanjë, Tetor 2022); të organizuar nga ReSPA në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në vijim të rekomandimit për miratimin e politikave të pagave për nëpunësit civilë, DAP ka zhvilluar disa aktivitete të rëndësishme.

Në kuadër të projektit të mëparshëm IPA “Zbatimi i reformës së Shërbimit Civil në Administratën Publike” më herët u kryen simulime si do të dukej skema e pagave duke shtuar hapat respektivë për secilën klasë.

Me partnerin ndërkombëtar SIGMA ka vijuar një proces konsultimi për të vlerësuar edhe një herë nëse kjo skemë pagash që aplikohet aktualisht me shtesën e promovimit në hapat e pagës, është e përshtatshme për Shqipërinë apo jo dhe çfarë eksperiencash mund të merren në konsideratë për të arritur një reformë në këtë drejtim.

Procesi i konsultimit ka përfshirë në total zhvillimin e tetë takimeve (që nga nisja e tij në datë 22 Dhjetor 2021 dhe fillim Korriku 2022).

Në takimin e fundit me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të nivelit të lartë (7-8 Korrik 2022) u diskutua mbi kriteret mbi të cilat do të bazohet rritja e pagave, mekanizmat dhe impakti financiar i kësaj reforme.

Çështje të ngritura për diskutim mbi hapat e pagës në shërbimin civil ishin:

- nëse duhet të ketë një rritje automatike, gjysëm automatike apo të mos ketë rritje automatike brenda hapave të pagës;
- kriteret në të cilat duhet të bazohet lëvizja midis hapave të pagës; si psh ndërlidhja me avancimin dhe kualifikimin profesional, aftësitë dhe kompetencat, cilësia e punës së performuar apo arritja e standardeve të përgjithshme të përcaktuara;
- përcaktimi nëse këto kriteret duhet të jenë të njëjta për grupe të ndryshme në institucione të ndryshme;
- pesha që duhet të kenë kriteret, si psh: vjetërsia 10 %, aftësitë dhe kompetencat 40%; cilësia e punës së performuar 50 %;
- ndërlidhja e kriterëve me nëpunësin dhe shtimi i disa karakteristikave të pozicionit (si kompleksiteti, zgjidhja e problemeve, etj) duke diferencuar kështu grupet e ndryshme sipas profesioneve;
- hapat kryesorë dhe nevoja për të shtuar hapa të rinj.

Për më tepër janë kryer rritjet dhe ndryshimet e pagave gjatë vitit 2022:

Paga minimale, në muajin mars 2022, (me VKM 158, datë 12.3.2022) u rrit nga 30.000 lekë në muaj, në 32.000 lekë në muaj me rritje mesatare në masën 6.67%.

Në muajin shtator 2022 (me VKM nr. 604, datë 14.9.2022) u rrit nga 32.000 lekë në muaj në 34.000 në muaj me rritje mesatare në masën 6.25%.

II. Ndër politikat e qeverisë shqiptare për vitin 2022, një reformë e rëndësishme është edhe rritja e pagave për: i) punonjësit mësimorë në arsimin parauniversitar, ii) për oficerët e nënoficerët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si edhe iii) për punonjësit e sistemit të shërbimit shëndetësor.

Për të mbështetur këtë politikë, në ligjin nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022" është përcaktuar edhe fondi i nevojshëm për rritjen e pagave, rritje që për këta sektorë u realizua si vijon:

- rritje të elementit të pagës "shtesë për pozicion" me 6%, për rreth 35.000 punonjës mësimorë në institucionet e sistemit të arsimit parauniversitar.
- rritje të pagës për gradë mesatarisht mesatarisht 30%, për rreth 6.000 oficerë dhe nënoficerë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
- rritje të elementit të pagës "shtesë për pozicion" mesatarisht 6%, për rreth 19.000 punonjës të sistemit të shërbimit shëndetësor në varësi të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- rritje të elementit të pagës "shtesë për pozicion" mesatarisht 6%, për 250 punonjës të shërbimit shëndetësor në sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në varësi të ministrit të Drejtësisë.
- rritje të elementit të pagës "shtesë për pozicion" mesatarisht 6%, për 70 punonjës të shërbimit shëndetësor në sistemin e Forcave të Armatosura në varësi të ministrit të Mbrojtjes.

Përveç sa më sipër, si rezultat i ndryshimeve në legjislacion, pati edhe rritje të pagave në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, ku u miratuan: ndryshime të niveleve të pagave pas kalimit nga sistemi pagë për gradë në sistemin pagë për funksion, me një rritje mesatarisht rreth 11%, për 146 punonjës në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.

Regjistri qëndror i personelit (RQP) është baza unike e të dhënave shtetërore, ku ruhet e përpunohet elektronikisht informacioni për institucionin dhe burimet njerëzore aktive, për institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. RQP përmban mbi 60000 dosje personeli të nëpunësve publikë.

Duhet theksuar se miratimi i VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrimit Qëndror të Personelit" ishte një hap i rëndësishëm që i hapi rrugën automatizimit të pagave përmes sistemit SIMBNJ.

Në zbatim të këtij vendimi, në Maj 2021, DAP dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë nënshkruan Udhëzimin e Përbashkët nr. 1, datë 21.05.2021 "Për formën, elementët dhe plotësimin e listëpagesës mujore të pagave dhe të urdhër-shpenzimit për pagat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" dhe në vijim të tij u hartua një plan pune për institucionet/njësitë shpenzuese, për të gjeneruar listëpagesën mujore përmes RQP dhe lidhjen automatikisht me Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) dhe për të kryer trajnimet përkatëse për të gjithë përdoruesit.

Gjithashtu, automatizimi i listëpagesave në institucionet e administratës shtetërore ka qenë indikator, pjesë e kontratës së mbështetjes buxhetore IPA 2015 për Reformën e Administratës Publike (kontratë e përfunduar) dhe aktualisht është pjesë e kontratës IPA II për Reformën Sektoriale "Bashkimi Evropian për Mirëqeverisje" (indikator nr.4 "burime njerëzore të përmirësuar").

Targeti i përcaktuar në kontratën IPA II për Reformën Sektoriale "BE për Mirëqeverisje" për vitin 2022: "Listëpagesat gjenerohen përmes SIMBNJ dhe paguhen automatikisht përmes SIFQ **për të gjitha institucionet e administratës shtetërore**", mbetet një sfidë për DAP, kjo pasi automatizimi i listës së pagave pengohet nga dy faktorë (i) konstrukti i RQP dhe (ii) kapacitetet e stafit që përdorin RQP.

Situata e COVID-19 e përjetuar gjatë viteve të fundit, me punë në distancë dhe vështirësi në ofrimin e trajnimeve të duhura, bëri që përpjekjet e DAP të përqëndroheshin në ruajtjen e status quo-së pasi nuk ishte e mundur rritja e numrit të institucioneve që gjenerojnë listën e pagave përmes RQP.

Përmirësimi i infrastrukturës së sistemit SIMBNJ/HRMIS për të vijuar përlogaritjen e pagave nëpërmjet këtij sistemi edhe për institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe sistemet me grada mbetet prioritet për DAP për periudhën në vazhdim.

DAP ka **vijuar të monitorojë modulin online (database) në lidhje me vendimet gjyqësore në institucionet e administratës shtetërore** në platformën www.administrata.al duke koordinuar punën me të gjitha institucionet e administratës shtetërore, me qëllim administrimin e të dhënave të sakta e në kohë reale, mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. DAP-i përveç monitorimit dhe kontrollit të punës së kryer nga përfaqësuesit e ministrive, asiston dhe i mbështet ata për zgjidhjen e problematikave të ndryshme që mund të hasen gjatë procesit duke unifikuar dhe procedurat konkrete.

Në mënyrë të vazhdueshme, personave përgjegjës në ministritë e linjës iu kërkohet informacion mbi vendimet gjyqësore të zbatuara dhe të pazbatuara si dhe një përmbledhje e ndryshimeve të ndodhura mbi të dhënat e pasqyruara sipas rubrikave në platformën e bashkëpunimit. Përgjatë vitit 2022 ky proces është përmbyllur në 19 raste gjyqfituesish, të cilët kanë qenë në listë për t`u sistemuar në një pozicion të rregullt të shërbimit civil.

Ndërkohë, nëse krahasojmë indikatorin e zbatimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të mbartura që nga fundi i vitit 2013 e në vijim, vërehet se në fund të vitit 2022 ky indikator është në nivelin **81.5%**, në krahasim me **79.3%** që ishte në fund të vitit 2021.

DAP është përgjegjës për zbatimin e 21 masave nën këtë shtyllë. Nga totali i tyre 15 janë realizuar plotësisht, 5 janë realizuar pjesërisht dhe një masë ka nisur zbatimin në vitin 2023.

Në lidhje me procedurat administrative dhe mbikëqyrjen në institucionet e pushtetit qendror, vendor dhe ato të pavarura, ka vijuar veprimtaria e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për nxjerrjen e udhëzimeve dhe rekomandimeve në lidhje me unifikimin e zbatimit të ligjit në shërbimin civil bazuar në problematikat e evidentuara nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në administratën publike.

Gjatë periudhës së raportimit, Komisioneri ka trajtuar **111** kërkesa nga nëpunës civilë. Referuar statusit të tyre apo mënyrës së trajtimit rezulton se në përfundim të hetimit administrativ:

- ka nxjerrë **61** vendime paralajmërimi në rastet kur janë konstatuar shkelje apo arkivimi pasi gjatë hetimit nuk janë konstatuar parregullsi (nga të cilat 18 raste i përkasin kërkesave të depozituara gjatë vitit 2021);
- në **13** raste, procesi i hetimit administrativ është mbyllur duke i kthyer përgjigje kërkuarit;
- **5** raste janë bashkuar me mbikëqyrjet;
- për **19** raste është duke vijuar procesi i hetimit administrativ.

Komisioneri ka kryer procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, dispozitë e cila urdhëron lirim nga shërbimi civil të nëpunësve që kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë. Për realizimin e këtij procesi është komunikuar me **181** institucione, pjesë e administratës shtetërore, njësi të vetëqeverisjes vendore dhe institucione të pavarura, sipas kësaj tipologjie: **90** institucione të Administratës Shtetërore: 12 (Kryeministria, 11 Ministritë e linjës dhe Institucionet në varësi të tyre) dhe 12 Prefektura; **73** Njësi të Administratës Vendore: 61 Bashki dhe 12 Këshilla Qarku; si dhe **18** Institucione të pavarura. Komisioneri ka dalë me vendime paralajmërimi për rregullimin e situatës në administrimin e shërbimit civil për **15** institucione ose për 17 raste nëpunësish në total që kishin plotësuar moshën për pension dhe vazhdonin marrëdhënien e punësimit (bëhet fjalë për 8 ministri, 6 bashki dhe 1 këshill qarku).

Komisioneri ka nisur procesin e mbikëqyrjes së përgjithshme në **88** institucione pjesë e shërbimit civil (bëhet fjalë për 5 institucione të pavarura dhe 76 njësi të qeverisjes vendore (bashki) dhe 7 ministri. Në rastin e ministrive, procesi është fokusuar tek instituti i vlerësimit të punës. Ndërsa në rastin e njërive të qeverisjes vendore, të cilat zënë edhe pjesën më të madhe të institucioneve të mbikëqyrura, ka vijuar procesi i nisur në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për analizën dhe sjelljen në standardet ligjore të strukturës organizative të institucionit. Gjithashtu ka vijuar verifikimi i zbatimit të vendimeve paralajmëruese për **31** vendime, për të cilat ka përfunduar afati për zbatimin e tyre. Në të gjitha rastet, procesi është përmbyllur, pasi rezulton se këto institucione i kanë zbatuar plotësisht rekomandimet apo detyrat e lëna nga Komisioneri.

Në zbatim të kompetencës ligjore për të mbikëqyrur administrimin e shërbimit civil, bazuar në nenin 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në zbatim të planit vjetor të veprimtarisë së institucionit, Komisioneri ka realizuar procesin e mbikëqyrjes për të siguruar zbatimin e ligjit për nëpunësin civil gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme në disa njësi të qeverisjes vendore (bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë).

KMSHC në planin e veprimit të SNRAP është përgjegjës për zbatimin e 6 masave, masa që janë të realizuara plotësisht.

Aktiviteti i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) gjatë vitit 2022 ka patur synim kryesor ngritjen e kapaciteteve dhe përgatitjen e administratës publike shqiptare në drejtim të integritetit evropian dhe zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil. ASPA ka trajnuar **5397** individë dhe **20780** pjesëmarrës në total në periudhën vitin 2022.


Treguesit e ASPA për vitin 2022:

Indikatori	Vlera 2022
Nëpunës civilë pjesëmarrës në trajnime	5397
Ditë trajnimi	665
Nëpunës civilë për ditë trajnimi	20780

Në vijim të procesit të vlerësimit të nevojave për trajnim janë evidentuar tematikat e trajnimit. **108** kanë rezultuar tematikat e trajnimeve duke përfshirë një gamë të larmishme të fushave prioritare të dalta nga procesi i vlerësimit të nevojave për trajnim.

Sa i përket trajnimit të trajnerëve kanë vijuar të zhvillohen trajnime në fushat e dokumentacionit të BE-si dhe vëmendje i është kushtuar gjithashtu dhe zhvillimit të trajnimeve në fushën e integritit evropian, fushën e barazisë gjinore, financave publike dhe prokurimit publik.

Statistika të trajnimeve për periudhën 2018-2022



ASPА ka përfunduar pilotimin e programit të trajnimit për kalimin nga Trupa e Nivelit të Lartë Drejtues, program i pilotuar me anëtarë ekzistues të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues dhe do të jetë i detyrueshëm për frekuentim në masën 70%. Programi i trajnimit vijoi duke respektuar modulet dhe orët e trajnimit të parashikuara në fillim të tij. Pas masave dhe punës intensive të zhvilluar për përdorimin e platformave online dhe përshtatjen e programit online, trajnimet rifilluan në datën 12 Maj 2020 në platformën online "Go To Meeting" të ASPA. Kohëzgjatja e parashikuar për modulet është ruajtur duke e përshtatur në trajnime online. Një modul i parashikuar 3 orë trajnimi në klasë, zhvillohet në dy webinarë nga 90 minuta. Përveç moduleve të parashikuara në program, këtij target grupi iu ofrua edhe trajnimi "Statistika si mjet për të ndihmuar vendimmarrjen dhe për të argumentuar vendimet e marra" në datë 18 Qershor 2020. Sesionet e trajnimit kanë përfunduar me sukses në Tetor të vitit 2020. Ky program u zhvillua sërish në vitin 2021 për pjesëmarrësit që nuk patën mundësi ta ndiqnin herën e parë dhe u mbyll me sukses në Nëntor të vitit 2021. Pjesëmarrësit realizuan webinarë të hapura të cilat kishin në fokus leadershipin për sektor.

ASPА është përgjegjëse për realizimin e 16 nën aktiviteteve nga të cilat 13 janë realizuar plotësisht dhe 3 janë realizuar pjesërisht.

Sfida dhe rekomandime:


- Rritja e atraktivitetit ndaj administratës publike dhe mbajtja e profesionistëve të talentuar nëpërmjet aplikimit të skemave të motivimit dhe një sistemi pagash stimulues.
- Vijimi i aftësisë të punonjësve të administratës publike, nëpërmjet diversifikimit dhe efikasitetit të programeve të ngritjes së kapaciteteve.
- Miratimi i standarteve të unifikuara për mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore në të gjitha institucionet e administratës publike, jo vetëm në institucionet e shërbimit civil.
- Rritja e cilësisë së Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues nëpërmjet efektivitetit të procedurave të rekrutimit dhe programeve trajnuese të dedikuara për ta.
- Implementimi i metodologjisë së re të vlerësimit të pozicioneve të punës dhe lidhja me kategoritë e pagave dhe përshkrimet e punës, për shërbimin civil.
- Thjeshtimi dhe përmirësimi i metodologjisë së vlerësimit të nevojave për trajnim dhe vlerësimit të cilësisë së procesit të trajnimit që ofrohet nga ASPA duke synuar më tej standardizimin dhe digjitalizimin e këtyre proceseve nëpërmjet Learning Management System (LMS) për të gjitha nivelet e qeverisjes. Përmirësimi i infrastrukturës së sistemit SIMBNJ/HRMIS për të vijuar përlogaritjen e pagave nëpërmjet këtij sistemi edhe për institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe sistemet me grada.
- Intensifikimi i punës me qëllim bërjen funksional të sistemit SIMBNJ/HRMIS në të gjitha institucionet e administratës publike, me qëllim rritjen e cilësisë së të dhënave për politikën e menaxhimit të burimeve njerëzore.
- Unifikimi i praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore në nivel qendror dhe vendor nëpërmjet (i) përmirësimit e përditësimit të platformës "administrata.al" dhe rritjes së numrit të përdoruesve e proceseve të kryera nëpërmjet saj, dhe (ii) shkëmbimeve të vazhdueshme mes profesionistëve të burimeve njerëzore në të gjitha nivelet e qeverisjes (peer to peer exchange) si pjese aktive e Rrjetit Profesional të burimeve njerëzore.

PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE MBIKËQYRJA


Politikat nën këtë shtyllë synojnë rishikimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut dhe thjeshtimin e tyre duke përfshirë zgjidhje të Teknologjisë së Informacionit si dhe duke marrë në konsideratë zbatimin e Kodit të ri të Procedurave Administrative, në drejtim të rritjes së përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë në kryerjen e funksioneve të tyre.

Shtylla IV “Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja” parashikon realizimin e 30 nën-aktiviteteve nga të cilat kanë filluar të zbatohen 29 nën-aktivitete (ose 97%) ku 25 prej këtyre të fundit janë realizuar plotësisht ose 86%.

Statusi i realizimit të qëllimit politik:
“Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja”



Statusi i realizimit të produkteve sipas objektivave



Lista e indikatorëve me vlerën bazë, vlerën e matur dhe vlerën e synuar në 2022

Indikatorët	Vlera Bazë	Vlera e matur në 2022	Vlera e synuar	Trendi (tendencë në ulje/tendencë në rritje/ arritur)	
9a. Sisteme të përmirësuara të IT-së për ofrimin e shërbimeve	0	10 sisteme të përmirësuara	8 agjenci	Arritur	
11a. Numri i ankesave të paraqitura çdo vit pranë Komisionerit përgjegjës për lirinë e informimit	58	1032	Tendencë në rënie	Tendencë në rritje	
11b Përqindja e rekomandimeve të zbatuara nga institucionet mbikëqyrëse të institucioneve të pushtetit qendror në dy vitet e kaluara.	RNoA=20%	R NoA = 13 % Tendencë në rënie/arritur R Acc = 52 % Tendencë në rritje R RfC = 7 % Tendencë në rënie/ arritur	R NoA = 17% Tendencë në rënie	R NoA arritur	
	RAcc=6%		R Acc = 48 % Tendencë në rritje	R Acc Tendencë në rritje	
	RRFC=43%		R RfC = 9.6% Tendencë në ulje	R RfC arritur	

Rezultatet e arritura në 2022:


Qytetarët dhe bizneset tashmë aplikojnë vetëm online nëpërmjet platformës e-Albania duke eliminuar vajtjen nga zyra në zyrë për të mbledhur dokumentet shoqëruese, duke shkurtuar kështu kohën dhe uljen e kostove, duke shmangur burokracitë dhe duke thjeshtuar procedurat e ofrimit të shërbimeve.

Ata ngarkojnë vetëm dokumente nga subjekte private ose vetëdeklarime. Të gjitha të dhënat dhe dokumentet qeveritare janë të pranishme dhe ripërdoren brenda administratës, duke u lehtësuar nga barra e grumbullimit fizikisht të kopjeve fizike në sportelet e shtetit. Të gjitha dokumentet që më parë kërkoheshin të mblidheshin nga qytetarët nuk u kërkohen më atyre.

Janë punonjësit që i sigurojnë këto dokumente në emër të qytetarit, duke shkarkuar versionin e tyre të vulosur nga platforma e-Albania ose duke ia kërkuar institucionit ofrues, nëpërmjet një sistemi elektronik të dedikuar të zhvilluar vetëm për këtë qëllim (Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve të Nënshkuara Elektronikisht).

Nëpërmjet këtij sistemi, punonjësit kërkojnë dokumentet e nevojshme nga institucionet që i gjenerojnë ato dhe këto të fundit përpunojnë kërkesën për këtë dokument. Pas nënshkrimit elektronik nga titullari i institucionit, dokumenti i kthehet përmes sistemit punonjësit që ka bërë kërkesën (proces që zakonisht zgjat 2 ditë në total).

Numri i e-shërbimeve cdo vit



Numri i shërbimeve elektronike niveli 3-4 (sipas UNPAN 2014)

Duke ndjekur këtë qasje, të gjitha shërbimet elektronike, aplikimet e të cilave janë të disponueshme vetëm online nga janari 2020, janë ndryshuar plotësisht në formatin e tyre duke standardizuar formularët e aplikimit:

- Dokumentet të cilat janë thjesht të listuara por që nuk janë përgjegjësi e qytetarit t'i sigurojë;
- Dokumentet të cilat përfshijnë vetëm vetëdeklarime dhe dokumente private dhe duhet të sigurohen nga vetë qytetari.

Platforma aktualisht ofron **1227 shërbime elektronike** dhe është e lidhur me Platformën e Ndërveprueshmërisë Qeveritare, e cila është arkitektura bazë dhe thelbësore që lejon ndërveprimin ndërmjet 58 sistemeve elektronike të institucioneve publike.

Disa indikatorë të rëndësishëm në këtë drejtim:

- 95 % e shërbimeve online;
- 2.8 milionë qytetarë dhe biznese të regjistruar;
- 27 milionë aplikime për shërbime publike;
- 55 dokumente me vulë elektronike;
- gjeneruar 23 milionë dokumenta;
- kursyer 990 vite pritje dhe 9 ml euro nga heqja e tarifave
- 58 sisteme elektronike të ndërlidhura me platformën ndërqeveritare;
- 200 milionë transaksione përmes Platformës Ndërqeveriare të Ndërveprimit;
- Numri i dokumentave me vulë elektronike 6,599,243;
- Numri i përdorimit të shërbimeve elektronike 15,847,288;
- 48,681 numri i dokumentave me vulë elektronike;
- 23 milionë numri i përgjithshëm i dokumentave të shkarkuar.

Platforma e Ndërveprueshmërisë Qeveritare mundëson që **66% e formularëve** të aplikimit të plotësohen automatikisht nga ndërveprimi dhe shkëmbimi i të dhënave ndërmjet këtyre regjistrave në kohë reale dhe kjo lehtëson plotësimin e formularëve online, duke shkurtuar kohën për qytetarin dhe duke garantuar saktësinë në plotësimin e fushave të aplikimit.

Në lidhje me indikatorin 9 a “Sisteme të përmirësuara të IT-së për ofrimin e shërbimeve” duhet theksuar se ky indikator do të vijojë të mbetet relevant për të mundësuar zhvillimin e një infrastrukturë të TIK-ut të aftë për të mbështetur aktivitetet e përditshme të administratës publike dhe rritjen e efikasitetit duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuar dhe transmetuar informacione, ndërkohë që bëhet përmirësimi i qarkullimit të informacionit.

Këto përgjigje tashmë ofrohen në një format digjital (të nënshkruar në mënyrë elektronike) nëpërmjet platformës e-Albania për profilet përkatëse individuale që kanë kaluar procedurën e aplikimit.

Kjo është edhe në përputhje me ligjin nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”, ku thuhet se ofrimi i shërbimeve nga të gjitha institucionet ofruese të shërbimeve, aplikimet e të cilave dorëzohen nëpërmjet platformës e-Albania, do të bëhet vetëm në mënyrë elektronike duke siguruar lëshimin e dokumentit përfundimtar me vlerë ligjore (vulë elektronike ose nënshkrim elektronik).

Në përputhje me dispozitat e nenit 61 të këtij ligji, dokumenti përfundimtar që është lëshuar në letër nga institucionet, lëshohet vetëm me nënshkrim elektronik.

Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, puna e administratës për kthimin e përgjigjeve po monitorohet plotësisht në kuadër të **Sistemit të Qarkullimit Elektronik të Dokumenteve**, duke i bërë shërbimet publike të jenë më efikase dhe transparente.

Monitorimi në kohë reale ndihmon në identifikimin e dobësive dhe drejtuesit e institucioneve marrin informacion në kohë reale me qëllim që të ndërhyjnë në zgjidhjen e problemeve dhe të shmangin vonesat.

Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të afatëve brenda Sistemit të Qarkullimit Elektronik të Dokumentacionit dhe përdorimin e sistemit në rastet kur duhet të bëhet shkëmbim i dokumentacionit shoqërues ndërmjet institucioneve deri kur shërbimi dhe dokumenti përfundimtar me një vulë elektronike ose nënshkrim elektronik u dorëzohet qytetarëve dhe bizneseve, sipas afateve ligjore.

Duke qenë se aplikimi për shërbim publik dhe dhënia e dokumentit përfundimtar po bëhet vetëm elektronike për 95% të shërbimeve, duke nisur nga maji 2022 qeveria vendosi të re-

duktojë trefish numrin e sporteve në vend. Të vetmet sporte që ende u shërbejnë qytetarëve *offline* janë ato që ofrojnë shërbime që kanë nevojë për praninë fizike të qytetarit (procedura e martesës, aplikimi për pasaportë/kartë identiteti ku kërkohen shenjat e gishtave etj.) ose automjeti (shërbimet e inspektimit).

Me uljen e numrit të sporteve, qeveria synon të kursejë kohë, para, të luftojë korrupsionin dhe të shmangë radhët e gjata për qytetarët dhe bizneset.

Punonjësit që punonin në *frontoffice* vazhdojnë t'i shërbejnë qytetarëve dhe bizneseve por në zyrat e pasme (*backoffice*), përmes sistemit elektronik (ku ofrojnë dokumentin përfundimtar të firmosur elektronikisht).

Zhvillimet në drejtim të digjitalizimit të shërbimeve publike kanë rezultuar shumë pozitive dhe përfshirja e AKSHI-t në sfida të reja do të mundësojë qëndrueshmëri dhe vijimësi të ofrimit të shërbimeve online. Aktivitetet do të rishkruhen për të siguruar një konsistencë në ofrimin e shërbimeve totalisht online, siguruar bashkëveprim dhe bashkërendim midis institucioneve dhe ndërgjegjësimit dhe asistimit të qytetarëve sa i takon ofrimin të shërbimeve.

AKSHI nën këtë strategji është institucion përgjegjës për zbatimin e 9 masave. 8 prej masave janë realizuar plotësisht dhe 1 pjesërisht.


Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) është institucioni përgjegjës për realizimin e objektivit 11: Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion.

Garantimi i të drejtës për informimin e qytetarëve është përmirësuar dukshëm, duke ndikuar në rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Gjatë vitit 2022, Zyra e Komisionerit ka rinisur monitorimin e Programeve të Transparencës së Autoriteteve Publike Qëndrore dhe të Varësisë me qëllim verifikimin e publikimit të Programit të Transparencës, të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve. Gjithashtu për realizimin e këtij objekti, gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar 61 monitorime online të faqeve zyrtare të NJQV dhe 313 monitorime të autoriteteve qëndrore dhe varësisë si dhe 15 hetime administrative pranë autoriteteve publike. Në përfundim të procesit të monitorimit rezulton se 56 NJQV kanë vënë në zbatim Programin e Transparencës për NJQV. Për njësitë e mbetura është referuar si një prej problematikave, aksesimi i faqeve për shkak të sulmit kibernetik të ndodhur në vitin 2022.

Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit (REKPD) u instalua edhe në **100 autoritete** të tjera publike duke e çuar numrin total në 195 autoritete publike dhe duke tejkaluar edhe shifrat e parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit si dhe Kontratën e Suportit Buxhetor 2020 për Mirëqeverisjen.

Numri i autoriteteve publike që kanë instaluar Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2018-2021



Në lidhje me rekomandimin mbi shtimin e më shumë institucioneve të përfshira në Regjistrin Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve (REKPD); si dhe monitorimin periodik të autoriteteve publike nëpërmjet instrumenteve të rinj të krijuara për matjen e Indeksit të Transparencës Proaktive në nivel lokal dhe qendror, të lënë në raportin e monitorimit të SNRAP 2021, ky rekomandim është plotësuar.

Gjithashtu në bashkëpunimin me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), është mundësuar krijimi dhe vënia në funksion e shërbimit të kërkesave për informacion publik dhe ankesave nëpërmjet portalit e-Albania. Ky bashkëpunim u finalizua me publikimin në portalin e-Albania të shërbimeve "Kërkesë për informacion publik" dhe "Ankesë për refuzim dhënie informacioni publik" dhe aktualisht, këto shërbime janë funksionale për 161 Autoritete Publike, ndërkohë që është në proces për t'u zgjeruar me autoritetet e tjera.

Koordinatorët për të drejtën e informimit janë trajnuar dhe njohur me modalitetet teknike të përdorimit të REKPD dhe përdorimin e sistemit të E-albania për marrjen dhe kthimin e përgjigjeve për të drejtën e informimit.

KDIMDP së bashku me Ambasadën Britanike në Tiranë, po bashkëpunojnë në kuadër të projektit "Improving the openness and accountability of the governments of the Western Balkans through the development of effective strategic communications". Ky projekt drejtohet nën kujdesin dhe angazhimin e Zyrës për Komunikim të Shërbimeve Ndërkombëtare të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Me mbështetjen e tij është hartuar, publikuar në faqen zyrtare të institucionit dhe është shpërndarë materiali mbi rolin e koordinorit për të drejtën e informimit, i cili përmban informacione dhe udhëzime praktike mbi veprimtarinë e tij. Pjesë e këtij projekti është edhe mbështetja në organizimin e nismës "Ditët e Transparencës" të zhvilluar me përfaqësues të autoriteteve qendrore rajonale dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore me qëllim mbështetjen e autoriteteve publike për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive kërkesave për informacion, si dhe detyrimeve ligjore për transparencë proaktive në qarqet: Berat, Elbasan, Kukës dhe Dibër.

[Në lidhje me ndryshimet e ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit"](#). Për të adresuar problematikat e ndryshme të hasura gjatë zbatimit të ligjit nr. 119/2014, por edhe sugjerimet/propozimet e vazhdueshme të grupeve të interesit, doli si domosdoshmëri nevoja e hartimit të ndryshimeve ligjore në këtë fushë. Për këtë qëllim, u hartua projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119, datë 14.09.2014 "Për të drejtën e informimit".



Projektligji është publikuar në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik në datën 19.10.2022 nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe ka qenë në proces konsultimi deri në datën 15.11.2022. Me shkresën nr.1962 prot., datë 29.12.2021, është dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë drafti i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", së bashku me relacionin shoqërues, për të vijuar me procedurat e mëtejshme ligjore deri në miratimin e tij.

Në lidhje me realizimin e indikatorit 11.a: Numri i ankesave të paraqitura çdo vit pranë Komisionerit përgjegjës për lirinë e informimit sipas metodologjisë së caktuar, rezulton që për vitin 2022 indikatorin e parë "Numri i ankesave" është 1032 ankesa përkundërt 992 ankesa të administruara gjatë vitit 2021. Ky indikator është në rritje. Ndërkohë indikatorin e dytë "Numri i sanksioneve me gjobë/hetimeve administrative" (nga 82 inspektive janë dhënë 3 sanksione

me gjobë) rezulton të jetë 0.03. Gjatë vitit 2021 ky indikator ishte 0.14. Shkaqet e tendencës në rritje të indikatorit të parë “Numri i ankesave” mund të vijnë nga rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve në lidhje me zbatimin e të drejtës për informim. Përsa i përket indikatorit të dytë “Numri i sanksioneve me gjobë/hetimeve administrative”, vlen të theksohet se ky raport është i ndryshueshëm bazuar në rastet e ankesave të administruara si dhe planin e punës së inspektimeve të Zyrës së Komisionerit për monitorimin e zbatimit të publikimit të Programeve të Transparencës.

KDIMDP është përgjegjës për zbatimin e **9 masave** nga të cilat **7 janë realizuar plotësisht** dhe dy janë realizuar pjesërisht (në nivel ecurie përrreth 90%). Masat e realizuara plotësisht do të vijojnë të jenë relevante dhe janë përkthyer gjithashtu në sfida për tu realizuar deri në përfundim të 2022 dhe në rast mosarritje deri në përfundim të strategjisë. Rekomandohet rishikimi i tyre dhe mënyra e matjes së realizimit për të parashikuar kështu masa të cilat janë sa më realiste konsideruar koston dhe burimet njerëzore të cilat duhet të jenë në dispozicion për të mundësuar realizimin e tyre.

Në lidhje me veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë 2022 janë adresuar në total 249 rekomandime drejtuar organeve të Administratës Publike duke përfshirë atë qëndrore dhe vendore.

Në total nga **249** rekomandime të adresuara, numri total i rekomandimeve të pranuar është **159 tek**sa numri i rekomandimeve të zbatuara plotësisht është **42 (26%)** ndërsa numri total i rekomandimeve të zbatuara pjesërisht është **89 (56%)**¹⁶.

Pavarësisht progresit të vërejtur në drejtim të uljes së përqindjes së kërkesave për shpjegime pa përgjigje, mbetet relevante për arritjen e indikatorit e njëjta problematikë e theksuar edhe në raportet e viteve të mëparshme: në shumë raste ka qënë e nevojshme ndërhyrja e avokatit të popullit me disa kërkesa të përsëritura, për të marrë një përgjigje, përfshirë këtu edhe rastet e përgjigjeve të dërguara jashtë afateve ligjore dhe të arsyeshme. Konkretisht, gjatë vitit 2021 nga institucioni i Avokatit të Popullit janë adresuar rreth 658 kërkesa të përsëritura për shpjegime.

Sfida dhe rekomandime:

- Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e të drejtës për informim në përputhje me standartet ndërkombëtare;
- Komunikimi proaktiv për konsolidimin e kulturës së transparencës të autoriteteve publike dhe bashkëpunimi me qytetarët dhe grupet e interesit për njohjen e kuadrit të modernizuar ligjor dhe rritjen e ndërgjegjësimit me qëllim zbatimin efektiv të tij;
- Zhvillimi dhe zgjerimi i marrëdhënieve ndërkombëtare brenda komunitetit global rregullator të të drejtës për informim.
- Harmonizimi i të gjithë kuadrit ligjor në fuqi me Kodin e Procedurave Administrative.
- Unifikim i praktikës për trajtimin e çështjeve të etikës dhe integritetit të nëpunësve publikë.
- Nevoja për të forcuar rolin e DAP-it si njësi e specializuar krahas rolit të ILDKPI, në çështjet e etikës dhe integritetit për nëpunësit në administratën shtetërore.
- Rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe zbatimi i tyre nga institucionet e administratës shtetërore.

¹⁵ Pra, referuar indikatorit 11b: raportit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht me rekomandimet e pranuar, ai është në nivelin 26 % (RACC). Ndërkohë, lidhur me rekomandimet pa përgjigje rezulton se për vitin 2022 janë 34 rekomandime ose 14% (RNOA) pa përgjigje. Pra, referuar raportit midis rekomandimeve pa përgjigje dhe rekomandimeve të adresuara në total nga Avokati i Popullit, rezulton se 7 % (RRFC) e tyre nuk kanë përgjigje.

Konkluzione dhe Rekomandime:

Mbi iniciimin e procesit të shkrimit të strategjisë së re SNRAP

- Konsultimi i fushave prioritare ku do të bazohet strategjia e re përmes komunikimit të vazhdueshëm me institucionet dhe aktorët e përfshirë në proces; organizimi i takimeve të përbashkëta midis aktorëve dhe palëve të përfshira;
- Fillimi i procesit përmes një urdhri zyrtar ku përcaktohen afatet dhe metodologjia që do të ndiqet për hartimin e Strategjisë së re;
- Përcaktimi i masave dhe mënyrës së matjes së realizimit në mënyrë realiste; ndjekja e procesit me ekspertizë të nevojshme për të siguruar që masat e përcaktuara janë realiste dhe të matshme dhe mundësojnë monitorim në baza vjetore;
- Kryerja e një analizë të kostove të planifikuara dhe aktuale të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë së RAP;
- Kostimi i planit të veprimit duke konsideruar që ky proces duhet të kryhet në përputhje të plotë me standardet IPSIS; ndjekje e procesit me ekspertizë të fushës për të siguruar kostimin e planit në baza vjetore që mundëson raportim realist mbi monitorimin e shpenzimit të burimeve financiare;
- Shkrimi i pasaportës së indikatorëve brenda afateve bazuar në shtyllat dhe objektivat strategjike të SNRAP; zhvillimi i konsultimeve dhe takimeve të dedikuara me institucionet për të garantuar mbulim në monitorimin dhe zbatimin e strategjisë dhe në nivel treguesi;
- Miratimi i strategjisë së re: brenda vitit 2023

KOMUNIKIMI I AKTIVITETEVE:

Vizibiliteti dhe komunikimi i aktiviteteve është një proces i rëndësishëm për Departamentin e Administratës Publike për të mbajtur të informuara të gjitha palët e interesuara mbi punën e përditshme të DAP.

Me anë të komunikimit të aktiviteteve, DAP mban një lidhje të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, institucionet, palët e treta apo qytetarët për t'i informuar ata mbi eventet që DAP organizon, si dhe duke mirëpritur komentet dhe reagimin e tyre.

Publikimi i aktiviteteve/ eventeve kryesore të DAP bëhet në rrjetet sociale të institucionit (Facebook dhe Twitter), në website të DAP (www.dap.gov.al), dhe në buletinin mujor të institucionit.

Kështu, ndër aktivitetet më kryesore në kuadër të reformës në administratën publike, gjatë gjashtë-mujorit të parë të vitit 2022 kanë qenë:

- Organizimi gjatë muajit Prill i tryezës së përbashkët për të nisur punën për strategjinë e re të reformës në administratën publike, me përfaqësues të delegacionit të Bashkimit Evropian, OECD/SIGMA, ReSPA, institucionet e administratës publike si dhe shoqëria civile.



Ky takim shërbeu për të analizuar dhe diskutuar mbi implementimin e SNRAP gjatë këtyre viteve, objektivat e realizuara me sukses, problematikat e hasura dhe rekomandimet për adresimin e tyre. Gjithashtu, event i shërbeu si një bazë për të diskutuar prioritetet për strategjinë e re 2023 e më tej.

- Në Qershor 2022 u mbajt **Konferenca 3 ditore Kombëtare e Antikorrupsionit**, e para e llojit të saj. Në panelin “Përdorimi i mekanizmave të ankesave dhe mjeteve digjitale në hetimin e korrupsionit”, Drejtori i DAP u ndal në prezantimin e arritjeve në fushën e rekrutimit të punonjësve në administratën publike duke theksuar se ky proces tashmë është transformuar tërësisht falë ngritjes së një sistemi të informatizuar dhe transparent.



Gjithashtu, u evidencua se rol të rëndësishëm në krijimin e një sistemi tërësisht të informatizuar kanë luajtur dhe partnerët ndërkombëtarë. Ky sistem tashmë, përveçse i informatizuar, është dhe i qendëruar, një risi që erdhi si rrjedhojë e digjitalizimit janë dosjet elektronike të aplikantëve që mund të përditësohen në çdo kohë nga kandidatët dhe banka e pyetjeve ku mbi 10 mijë pyetje gjenerohen nga sistemi.

- Konferenca ndërkombëtare “Bazat e mirëqeverisjes për menaxhimin e cilësisë në administratën publike”. Konferenca mbledhi së bashku përfaqësues të nivelit të lartë të administratës shqiptare si dhe partnerët ndërkombëtarë OECD/SIGMA dhe ReSPA.

Gjatë konferencës u prezantua rëndësia e menaxhimit të cilësisë si dhe praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Europian në zbatimin e parimeve të tij në administratën publike. Një temë tjetër që diskutuan pjesëmarrësit ishte dhe qasja strategjike për menaxhimin e cilësisë si drejtimi kryesor i qeverisjes së mirë dhe udhërrëfyesi i administratës publike Shqipëria 2030.



6 KORRIK - KONFERENCA NDËRKOMBËTARE “BAZAT E MIRËQEVERISJES PËR MENAXHIMIN E CILËSISË NË ADMINISTRATËN PUBLIKE”

- Një event tjetër i rëndësishëm në Qershor 2022 ishte organizimi i konferencës rajonale për reformën e administratës publike, organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me përfaqësues të institucioneve të administratës publike si dhe organizata të ndryshme dhe shoqëria civile.



Në event u diskutuan çështje të rëndësishme për reformën në administratën publike, si nxitja e reformave të qëndrueshme, llogaridhënia dhe integriteti publik.



Nxitja e reformave të qëndrueshme dhe me integritet të administratave publike të Ballkanit Perëndimor



Gjatë aktivitetit dy-ditor u diskutuan gjetjet nga monitorimi në fushën e Reformës së Administratës Publike dhe u ndanë përvojat dhe sfidat e përbashkëta për administratën publike në Shqipëri dhe në rajon.

Evente të tilla shërbejnë si urë lidhëse për të rritur më shumë bashkëpunimin midis institucioneve dhe shoqërisë civile për të hartuar dhe zbatuar politika gjithëpërfshirëse dhe transparente në shërbim të qytetarit.


Në kuadër të projektit WeBER 2.0 në Nëntor u zhvillua nga Qendra e Politikave Evropiane (CEP) Konferenca e tretë rajonale “Qytetarët në radhë të parë” në Beograd. Gjatë eventit u ndanë gjetjet e ciklit të tretë të monitorimit të Reformës në Administratën Publike për vitin 2021 dhe 2022 ku u diskutuan arritjet, rëndësia e modernizimit dhe digjitalizimit të administratës publike, si dhe sfidat e reformës si një faktor i rëndësishëm për integrimin në BE. Përfaqësuesit e Departamentit të Administratës Publike theksuan rolin e rëndësishëm që luajnë organizatat e shoqërisë civile në lidhje me monitorimin e reformës duke kontribuar me analizë dhe rekomandime relevante në zbatimin e reformës.

- Gjithashtu, gjatë muajit Qershor, Departamenti i Administratës Publike mirëpriti në ambjentet e institucionit, delegacionin nga Ministria e Administratës Publike, Shoqërisë Digjitale dhe Mediave të Malit të Zi. Kjo vizitë u zhvillua në kuadër të programit të shkëmbimit të eksperiencave me vendet e rajonit, mundësuar nga skema e mobilitetit të Shkollës Rajonale të Administratës Publike ReSPA.

Gjatë takimit u diskutua mbi ofrimin e shërbimeve publike dhe menaxhimin e burimeve njerëzore nga institucionet e administratës publike në Shqipëri.

Gjithashtu, DAP i prezantoi delegacionit malazez platformën “administrata.al”, si sistemi i vetëm i qendëruar i informacionit që ndihmon nëpunësit e administratës publike në punët e tyre të përditshme.


Takime të tjera u zhvilluan edhe pranë Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Zyrën e Kryeministrit, Agjencisë së Komunikimit të Shoqërisë së Informacionit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ku u diskutua në lidhje me funksionimin e mekanizmave të koordinimit, praktikës mbi mirëmenaxhimin e kontratës së mbështetjes buxhetore, digjitalizimit të procedurave dhe zbatimit të agjendës digjitale në Reformën e Administratës Publike.



Aneks: Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit të strategjisë

Plani i Veprimit 2018-2022 i kostuar parashikon që kosto totale e zbatimit të aktiviteteve është 1,972,158 mijë ALL, nga të cilat 944,391 mijë ALL mbulohej nga buxheti i shtetit, 875,535 mijë ALL nga donatorët dhe 152,232 mijë ALL (8%) është hendeku financiar.

Grafiku: Burimet e financimit



Nga analiza që DAP ka bërë bazuar në Planin e Aktiviteteve 2018-2022 të kostuar, vëmendja duhet të përqendrohet në drejtim të objektivave me hendek financiar. Në vlerë totale hendeku financiar është 152,232 mijë ALL ose 8% e koston totale të parashikuar të zbatimit të aktiviteteve të SNRAP.

Megjithatë vlen të përmendet që disa prej nën-aktiviteteve të parashikuara janë realizuar dhe do të realizohen nëpërmjet punës së institucioneve të përfshira në zbatimin e strategjisë si detyra shtesë funksionale të nëpunësve publikë çka nuk përkthehet në kosto shtesë faktike apo nevojë të mëtjeshme për mbulim apo financim.



Ky raport u hartua nga Departamenti i Administratës Publike
Bulevardi "Zogu i parë" - Tirana, Albania

042250488 info@dap.gov.al
www.dap.gov.al